



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:086778

Datë: 07.06.2023

Numri i dokumentit: 04370620

PS.nr.32/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL, në përbërje të trupit gjykues, gjyqtarëve Arben Hoti- kryetar, Mentor Bajraktari dhe Lutfi Shala - anëtar të trupit gjykues dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurve L B për shkak të veprave penale Pastrim i parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par. 1 nën par 1.1, nën par. 1.5 dhe par 3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të pandehurit L B, D M dhe I P për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1 nën paragrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i pandehuri L B për shkak të veprës penale Pastrim i parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par. 1 nën par 1.1, nënpar.1.5 dhe par. 3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, gjithashtu të pandehurit L B dhe M S për shkak të veprës penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nënpar.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr 35/2015 të dt.09.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 24.03.2023 në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës – Florije Shamolli, përfaqësuesi i palës së dëmtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëposhtëm AKP) – L S, i pandehuri L B me mbrojtësin av.Rama Gashi, D M me mbrojtësin av.Florent Latifaj, I P me mbrojtësin av.Agron Selimaj dhe M S me mbrojtësin av.Xhafer Maliqi të gjithë mbrojtës sipas autorizimit, pas seancës për këshillim dhe votim me datë 03.04.2023, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurve:

1. L B nga i ati ... dhe nëna ..., i lindur me dt.... në Prishtinë, ku dhe jeton në rr "...", objekti ..banesor, kati I, hyrja numër ..., lagja Aktash, i martuar, ka të kryer shollën e mesme, ish ...i Ndërmarrjes së Re Llamkos 2005-2007, tani punon si menaxher në kompani me '...', i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, Nr. personal;
...
2. D M, nga i ati .. dhe nëna ..., i lindur me dt.... në Prishtinë, ku dhe jeton në rr. ".." nr..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, ... i biznesit në fabrikën e peletit në Pejë, bashkëpronar ne biznesin "alcon" në atë kohë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Nr. Personal
3. I P, nga i ati ... dhe nëna ..., i lindur me dt.... në Prishtinë, ku dhe jeton në rr "...", lagja (...), me profesion ekonomist, i martuar, tani punon si menaxher në një kompani softverike, më parë bashkëpronar i biznesit "...", i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. personal ...
4. M S nga i ati .. dhe nëna ..., e vajzërisë, i lindur me dt.... i lindur në Vushtrri tani me vendbanim në Prishtinë, ku dhe jeton në rr "...", kati 1, nr..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, pronar i biznesit "...", (biznes i cili ekziston ende), i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Me nr. personal ...

Konform nenit 363 par.1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, të pandehurit:

LIROHEN NGA AKUZA

SEPSE:

II.

I pandehuri L B

-Me dashje, duke ditur se pasuria e fituar buron nga aktiviteti kriminal, me qëllim të konvertimit, transferimit dhe fshehjes së natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë, respektivisht nga shërbimi i kundërligjshëm të kryer në dobi të të pandehurve D M, K dhe I P patundshmërinë – parcela në sipërfaqe prej 10,000 m², zona kadastrale nr.P-72217022-... Nerodime e Epërme, Komuna Ferizaj dhe me qëllim të fshehjes dhe maskimit të burimit të prejardhjes së pasurisë, e ka lidhur kontratën për kinse blerjen e patundshmërisë (kontrata mbi shit blerjen VR... e datës 20.10.2005 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj në shumë kontraktuese prej 6,000.00 € të cilën shumë në realitet i pandehuri asnjëherë nuk e ka paguar.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Pastrimi i parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nën par. 1.1, nën par.1.5 dhe par.3 nën par. 3.1 të Ligjit nr.05/L096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

III.

Të pandehurit L B, D M, A K dhe I P

-Në cilësinë e personave përgjegjës në organizatën e biznesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, me qëllim të realizimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete, në bashkëveprim me njëri – tjetrin, kanë marr pjesë në kryerjen e veprës penale, duke shkelur ligjin dhe rregullat e veprimtarisë afariste lidhur me tjetërsimin, përdorimin dhe menaxhimin e pasurisë, ashtu që me urdhrin e të pandehurit L B, ..i Ndërmarrjes së Re “...”, tani në likuidim, me datë 25.02.2007 në këtë ndërmarrje është faturuar shitja e mallit – llamarinë e zinkuar, për ndërmarrjen fiktive NTP “..” si blerës, në vlerë të përgjithshme prej 487,176.93 €, ku pastaj një pjesë e mallit në shumë prej 224,820.72 € me urdhrin e të pandehurit L B është transportuar në depon e fabrikës së vajit “..” në Ferizaj, me bashkëpronar të pandehurit D M, A K dhe I P, të cilin mall ata asnjëherë nuk e kane paguar dhe ende figuron si borxh ndaj Ndërmarrjes së Re “...” tani në likuidim me të cilat veprime të pandehurit L B, D M, A K dhe I P e kanë dëmtuar Ndërmarrjen e Re “..” tani në likuidim në shumë prej 224,820.72 €.

- Me këtë të pandehurit në bashkëkryerje nga neni 31 i KPRK-së kishin për të kryer veprën penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1, nën par.1.5 të KPRK-së.

IV.

I pandehuri L B

-Me dashje, duke ditur se pasuria e fituar buron nga aktivitetet kriminale, me qëllim të konvertimit, transferimit dhe fshehjes së natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë, respektivisht për shpërblimin e kundërligjshëm të kryer në dobi të të pandehurve D M, A K dhe I P, më detajisht e përshkruar si në pikën III të aktakuzës, i pandehuri D M me datë 11.07.2008 ka deponuar të pandehurit L B në xhirollogarinë e tij nr.... në ProCredit Bank shumën prej 100,000.00 € ku pastaj me qëllim të fshehjes dhe maskimit të burimit të prejardhjes së pasurisë i pandehuri L B se bashku me persona të tjerë me datë 25.05.2009 ka themeluar kompaninë .. Sh.p.k ku në xhirollogarinë e këtij biznesi nr... në NLB i pandehuri L B me datë 27.10.2009 ka deponuar shumën prej 1,900.00 €, me datën 20.12.2009 shumën prej 35,000.00€ (gjithsej 36,900.00 €) si dhe me datën 21.08.2009 në xhirollogarinë e këtij biznesi ... në TEB shumën prej 7,500.00 €.

- Me këtë i pandehuri kishte për të kryer veprën penale Pastrim i parave nga neni 308 i KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nën par.1.1, nën par.1.5 dhe par.3 nën par.3. të Ligjit nr.05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

V.

Të pandehurit L B dhe M S

-Në cilësinë e personave përgjegjës në organizatën e biznesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, me qëllim të realizimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete, në bashkëveprim me njëri – tjetrin kanë marr pjesë në kryerjen e veprës penale duke shkelur ligjin dhe rregullat e veprimtarisë afariste lidhur me tjetërsimin, përdorimin dhe menaxhimin e pasurisë ashtu që me urdhrin e të pandehurit L B drejtor i Ndërmarrjes së Re “..” tani në likuidim, gjatë muajit Shkurt 2007 në këtë ndërmarrje është faturuar shitja e mallit – lllamarinë e zinkuar për ndërmarrjen fiktive NTP “..” si blerës, në shumë prej 143,598.06 € i cili marr pastaj me urdhrin e të pandehurit L B është transportuar në Ndërmarrjen e Re “..” tani në likuidim tek Ndërmarrja “..” në fshatin Bukosh, Komuna Vushtrri, me pronar – i pandehuri M S të cilin mall i njëjti

asnjëherë nuk e ka paguar me të cilat veprime të pandehurit L B dhe M Se kanë dëmtuar Ndërmarrjen e Re “...” tani në likuidim në shumë prej 143,598.06 €.

- Me këtë të pandehurit në bashkëkryerje nga neni 31 i KPRK-së kishin për të kryer veprën penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1, nën par.1.5 të KPRK-së.

E dëmtuara Agjencia Kosovare e Privatizimit AKP për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

Shpenzimet e procedurës bien ne barre te mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

1.1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë me numër PPS.nr.35/2015 me datë 04.10.2018 kundër të pandehurve D M, A K, I P dhe L B në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Pastrim i parave nga neni 56.1 nën par 1.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e terrorizmit ligji nr.05/L-096, kundër të pandehurve D M, A K, I P, L B, M S, R P dhe R M në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Keqperdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nën par.1.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e terrorizmit Ligji nr.05/L-096.

1.2. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me datë 09.10.2019 sipas kërkesës së gjykatës ka ndryshuar aktakuzën me numër PPS.nr.35/2015 dhe ka bërë precizimin e aktakuzës PPS.nr.35/15 të dt.04.12.2018, kundër të pandehurve L B, D M, I P, M S, R P dhe R M. Ashtu që kundër të pandehurve L B D M, A K dhe I P aktin akuzues e ka precizuar në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.1 nën par.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurit L B në drejtim të veprës penale Pastrimi i parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nën par. 1.1, nën par.1.5 dhe par.3 nën

par. 3.1 të Ligjit nr.05/L096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, kundër të pandehurve L B, D M, A K dhe I P në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1, nën par.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kundër të pandehurit L B në drejtim të veprës penale Pastrim i parave nga neni 308 i KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nën par.1.1, nën par.1.5 dhe par.3 nën par.3. të Ligjit nr.05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, kundër të pandehurve L B dhe M S në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1, nën par.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

2. Shqyrtimi fillestar

2.1. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti Special në këtë çështje juridiko - penale ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 22.10.2019, në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit të gjithë të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre.

Të pandehurve i është lexuar aktakuza, ndërsa kryetari i trupit gjykues pasi është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën të njëjtëve ju dha mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarojnë të pafajshëm.

Të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë për asnjërën nga pikat e aktakuzës.

2.2. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special me datë 05.12.2019 ka marr aktvendim PS.nr.32/2019 me të cilin ka hedhur pjesërisht aktakuzën e PSRK-së PPS.nr.35/2015 të datës 09.10.2019 si në pikën I dhe VI të saj dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurve L B, D M, A K dhe I P për shkak të veprës penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së nga dispozitivi i I (një) i aktakuzës dhe të pandehurve L B, R P dhe R M për veprën penale nga dispozitivi VI (gjashtë) i aktakuzës, Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 31 pasi që prokurori i shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale si në dispozitivin I dhe VI të aktakuzës për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Në të njëjtin aktvendim kjo gjykate ka refuzuar kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës të ushtruar nga palët për dispozitivin II, III, IV dhe V të aktakuzës së ndryshuar.

2.3. Gjithashtu gjykata me të njëjtin aktvendim ka pushuar procedurën penale kundër të pandehurit A K për shkak se i njëjti ka vdekur – gjë e cila është vërtetuar edhe me certifikatën e vdekjes me nr.ser... të dt.04.12.2019 të lëshuar nga MPB – Republika e Kosovës.

2.4. Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës me datë 21.01.2020 ka marr aktvendim me të cilin ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve dhe ka vërtetuar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special PS.nr.32/19 të dt.05.12.2019.

3. Shqyrtimi gjyqësor dhe deklarimi i dëshmitarëve

3.1. Pasi që të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve, në të cilën prokurori i shtetit dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin rastin dhe kërkesat e tyre, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve.

3.2. Dëshmitari A E në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohet deklarata që e ka dhënë në polici dhe qëndron pranë saj. Se në vitin 2007 ka poseduar kamionin me targa 315-KS-016, me atë kamion ka punuar si vozitës duke bërë transport, gjë për të cilën është paguar. Dëshmitari ka deklaruar se vetëm njëherë ka bërë transport për firmën Llamkos dhe për transportin në fjalë e kanë thirrur A dhe A (edhe këta vozitës të kamionëve – transportues), me të cilët janë njohur mes veti. Dëshmitari ka theksuar se ai vet nuk është “goditur” (pra ka zhvilluar ndonjë negociatë për çmimin e transportit) me askënd tjetër përveç me personat në fjalë – kolegët e tij, të cilët ja kanë dhënë paratë pasi është kryer transporti. Dëshmitari më tutje ka dëshmuar se fabrika në fjalë gjendet në Vushtrri dhe ai është ngarkuar me mallin llamarinë por nuk i kujtohej pesha dhe llamarinën e ngarkuar e kishte dërguar në fabrikën e re të vajit në Ferizaj. Më tej ka shtuar se atje kanë shkuar njëri pas tjetrit por nuk i kujtohej se kush i ka pritur atje sepse kishin mbërritur vonë, ku më pastaj aty i kanë lënë kamionët dhe shokët e tij e kishin dërguar deri te makina e tij dëshmitarin dhe të nesërmen përsëri e kanë dërguar dhe kanë shkarkuar kamionët. Sa i përket pagesës dëshmitari ka deklaruar se A i ka marrë për të tre dhe ai ka qenë i ngarkuar me llamarinë duke thënë se kjo ka ndodhur vetëm njëherë.

3.3. Dëshmitari N A në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: që ka dhënë deklaratë në polici dhe qëndron pranë saj. Ka qenë në marrëdhënie pune me USAID me projektin Kosovo

Biznes Support deri në mesin e nëntorit 2005 ndërsa gjysmën e dytë të nëntorit 2005 deri në vitin 2008 ka qenë në “..” drejtor financiar, se pronar i Llamkos ka qenë “..” i Bullgarisë me pronar V Z ndërsa L B kishte qenë drejtor gjeneral. Gjatë kohës sa ka qenë drejtor financiarë dëshmitari përgjegjësitë i ka pasur të caktuara me terma të referencës ku fillimisht ka udhëhequr kontabilitetin e të gjitha transaksioneve ekonomike, ka përgatitur pasqyrat, raportet financiare etj, duke pasur edhe qasje në arkë. Dëshmitari më tej ka shtuar se në rast të ndonjë transferimi të hollave nga dikush ka pasur qasje në pagesa sepse ka qenë bashkë nënshkrues i urdhëresave dhe këto ishin rregulla të bankave në kuadër të transaksionit. Sa i përket transaksionit në vlerë prej 172,312.89 euro nga “Gini Trade” në vitin 2006 dëshmitari ka deklaruar se nuk i kujtohet ai transaksion. Se në kuadër të menaxhmentit ka pasur edhe personel bullgar për të cilët ka theksuar se supozon se janë punësuar nga pronari, ndërsa L si drejtor kishte pasur një zëvendës i cili ka qenë bullgar me mbiemrin D dhe aty kishin qenë edhe 3-4 të tjerë në cilësinë teknik apo inxhinierë dhe në çështjen administrative. I njëjti më tej ka shtuar sa i përket raportimeve ato janë bërë në baza të rregullta mujore duke shkuar drejtpërdrejtë edhe në Sofje – Bullgari, ku ishte qendra e kompanisë. Sa i përket pronarit bullgar me sa i kujtohej dëshmitarit i njëjti nuk ka pasur vërejtje ndaj menxhmaentit të “Llamkos”. Dëshmitari ka shtuar se kanë pasur raporte afariste me kompani të ndryshme privat dhe publike, e që kryesisht shitjet që ishin bërë ishin bërë me avance andaj edhe nuk i kujtohej që ka pasur procedure gjyqësore për arkëtimin e shumave të arketueshme – borxheve për periudhën 2005-2007. Se firma “Llamkos” ka qenë ndërmarrje që është shitur me privatizim dhe ndërlidhja e vetme që ka qenë me AKP-në ka qenë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e spinoff-it special, i njëjti ka shpjeguar se spin-off është procedurë e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ku blerësi obligohet ti përmbushë disa detyrime që kanë të bëjnë me investimet në fabrike dhe në punësim pra punësimin e numrit të caktuar të punëtoreve e që AKP pastaj e bënë përcjelljen e atyre dy zotimeve të cilat janë obligime kontraktuale të shitjes me spin-off special e që për gjëra të tjera AKP nuk ka pasur lidhje me fabrikë për shitje të produkteve apo blerjes së lëndës së parë duke shtuar se duhet të dihet roli i AKP që është servis i shtetit për shitjen e ndërmarrjeve ku AKP e kryen rolin e agjencisë në relacion dhe nuk përfiton apo humbe nga ajo punë por vetëm kryen një shërbim për shtetin. Dëshmitari ka deklaruar gjithashtu se zotimi i punësimit ka qenë i tejkualuar e as nuk kanë pas vërejtje nga AKP për kushtet e marrëveshjes ndërsa zotimi për investime kishte ngecur nuk ishte kryer në shumën e zotuar andaj në vitin 2009 AKP e ka kthyer prapa kompaninë duke realizuar të drejtën sipas kontratës. Dëshmitari lidhur me investimet ka theksuar se shumat për investim kanë qenë dashur të merren prej fondeve të pronarit dhe përfitimet e shitjes.

Në lidhje me faturat dëshmitari ka dëshmuar se vetëm me nënshkrimin e drejtorit L B dhe të tijën si drejtor financiar fatura ka mundur me dërguar në banke, pastaj banka ka bërë kontrollin e që shuma që ishte dashur të paguhet rrjedh detyrimi që “..” e kishte pasur ndaj furnitorëve të vet, ndërsa miratimin e kishte bërë një përgjegjës që e ka pranuar mallin duke e nënshkruar atë e që më vonë kishte shkuar në departamentin e furnizimit të cilët kanë kërkuar nga departamenti i financave të ekzekutohet pagesa. Pra në këtë pjesë të dëshmisë së tij dëshmitari ka treguar procedurën kur “..” ishte në cilësinë e blerësit.

Dëshmitari ka deklaruar se kanë pas kontrolle nga AKP për arsyen e kërimit të rimburesimit të TVSH të cilët e kishin kryer punën e vet duke e caktuar shumën që duhej të rimburesohej, pra “Llamkosi” kishte qenë në parapagim të TVSH-së me vlera të larta dhe një moment të caktuar kur janë pjekur kushtet ligjore për rimburesimin e TVSH-së e kanë paraqitur kërkesën për kthimin në ATK e që këta të fundit kishin shkuar me vërtetuar saktësinë e asaj çka po kërkohet për kthim duke e lëshuar raportin e tyre lidhur me procesin e kontrollit. Se AKP në ndërhyrje të transaksioneve afariste nuk ka pasur fare lidhje mirëpo e ka rezervuar të drejtën e tyre që kompania ti shitet një pale tjetër pa pëlqimin e AKP, e që investitori bullgar më vonë e kishte bërë ndryshimin e pronarit me bekimin e AKP-së e që Llamkos i ishte dhënë një kompanie të Indisë me pronar Italian gjë e cila kishte ndodhur në fillim të vitit 2007.

Në pyetje të gjykatës: te marrëveshja me AKP –në për privatizim a ka pas ndonjë shumë të përcaktuar për investime, dëshmitari është përgjigjur; ajo ka qenë vlere e kontratës dhe është dashur të jetë 15 milion euro sipas zotimit të blerësit dhe ka qenë pjese kontraktuale e kontratës për shit-blerje. Përmes raporteve të rregullta tre mujore AKP është njoftuar për përmbushjen e investimeve me qëllim që të dokumentohet raporti për investime dhe punësim duke dërguar listën e punëtorëve dhe dëshmi për pagesat e pensioneve, mirëpo vlera e sakte e investimeve nuk i kujtohet sipas dëshmitarit ka qenë 2-3 milion euro, por jo mjaftueshëm për tu përmbushur investimet e zotuar, ka përfunduar dëshmitari.

3.4. Dëshmitari N S – për këtë dëshmitar gjykata ka lexuar deklaratën e tij të dhënë me datë 16.10.2012 në njësinë DSAK meqenëse i njëjti sipas certifikatës të siguruar ka vdekur, ku kishte deklaruar se personin me emrin Sh S e ka pasur vëlla, por nuk e ka ditur se i njëjti ku ka banuar meqenëse nuk i kishte pasur marrëdhëniet e mira me të njëjtin ngase ai kishte qenë problem. Sa i përket firmës “..” dëshmitari ka deklaruar se nuk e ka njohur atë firmë, por e dinë se për

periudhën 2004-2005 vëllai i tij kishte kërkuara para te djali i tij J në vlera të vogla dhe se ishte marr policia me të. Gjithashtu ka theksuar se vëllai i tij Sh S nuk e din nëse ka pasur ndonjë biznes e meqenëse nuk kishte kontakte e as marrëdhënie të mira më të njëjtin për të kishte dëgjuar se po kërkon lëmosh rrugëve të Prishtinës. Krejt në fund të deklaratës ka dëshmuar se nuk ka çfarë të shtoj sa i përket pyetjeve për vëllain e tij përveç se e ka pasur vëlla e që nuk kanë pasur asnjë të përbashkët me të.

3.5. Dëshmitari A A në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar se; në vitin 2007 i kujtohet se kanë shkuar në fabrikën “...” sepse kanë pas me ngarkuar mall dhe kërkesën e ka pas nga shokët e tjerë që janë marr me transport me të cilët kanë bashkëpunuar dhe se fabrika në fjalë ka qenë në Vushtrri. Dëshmitari ka theksuar se nuk e din kush ka qenë pronar i asaj fabrike sepse nuk kane pasur qasje në atë çështje por kanë pasur të bëj me ngarkesa dhe me dërguar në destinacion. Atë fabrike e njeh pasi që ke kanë bërë ngarkesa me llamarinë dhe me sa i kujtohet dëshmitarit ai ka bërë dy rrugë te ish fabrika e vajit ku atje e kanë shkarkuar dhe e kanë lënë mallin. Dëshmitarit nuk i kujtohet nga kush është paguar por e din se të hollat i ka pranuar nga koleget e tij. Se llamarinë përveç që ka dërguar në Ferizaj thekson se tjetër kund nuk ka dërguar. Dëshmitari më tej ka shtuar se nuk ka njohuri për firmën “...” nga Prizreni dhe atje asnjëherë nuk ka dërguar mall. Dëshmitari në fund ka deklaruar se gjatë transportit ka qenë i pajisur me një flet- dërgesë shumë e thjeshtë dhe se pagesën e ka pranuar nga shokët e tij në kesh, sepse atëherë ka qenë kohë tjetër jo si tani ka shtuar dëshmitari.

3.6. Dëshmitari A G në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohet që ka dhënë deklaratë në polici me datë 28.12.2012 dhe qëndron pranë saj. I kujtohet se ka pas kamion me rimoriko në vitin 2007 deri në vitin 2009 me targa të regjistrimit ... duke shtuar se ka qenë pronar i kamionit në fjalë, me atë kamion ka transportuar kur ka pasur kërkesa dhe në vitin 2007 ka pasur transport jashtë Kosovës dhe në Maqedoni. I kujtohet se ka transportuar mall për fabrikën ”..” me seli në Vushtrri dhe malli që e kanë transportuar ka qenë llamarinë e paketuar, se prej firmës “...” dëshmitari thekson se ka bartur dy apo tre herë për në fabrikën e vajit në Ferizaj. Dëshmitari ka shtuar se llamarina ka qenë rollne e madhe që i thonin “bund” diku 10 deri 12 ton (T) në peshë për një bund. Se puna e transportit nuk e din se si i ka ardhur, i kujtohet se në “...” mallin e kanë marr me faturë, në peshore kanë hy në fabrikën “...” pastaj kanë dal dhe kur kanë shkuar në fabrikën në Ferizaj prapë janë matur dhe se një njeri te peshorja i ka marr faturat.

3.7. Dëshmitari F J në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se ka dhënë deklaratë më herët e njëjta i kujtohet dhe qëndron pranë saj. Dëshmitari ka deklaruar se ka punuar në fabrikën në Ferizaj prej vitit 2001 deri 2011 vetëm në sektorin e shitjes se pronar kanë qenë tre persona të Prishtinës dhe drejtor gjeneral ka qenë D M, ndërsa aksionarë kane qenë I P dhe A K se ata si aksionar kanë kryer edhe punë të përbashkëta por pak a shumë edhe i kanë pas të ndara, njëri në prodhim, tjetri në financa dhe tjetri komercionale. Se të gjitha fabrikave pas privatizimit i janë ndërruar emrat gjithashtu edhe fabrikës së vajit i është ndërruar emri dhe pastaj është quajtur “..” ku pasi është ndërruar emri i fabrikës aty kane pasur prodhim të vajit ushqyes dhe yndyrave bimore. Dëshmitari ka shtuar se në atë fabrikë ka pasur hapësira të lëshuara me qira, ku ajo fabrike kishte lëshuar hapësira me qira për deponim të mallit të cila ka qenë në mënyrë legale dhe me kontrata valide dhe i kujtohet se më shumë ka pas deponim me qira nga “Raiffaisen Bank”. Dëshmitari ka dëshmuar se i kujtohet se edhe një kohë ka pas llamarinë por nuk e dinë se kujt i është dhënë ajo me qira sepse dëshmitari është marr me shitje, ka punuar në zyrë por edhe në terren, por si deponim e ka parë se është deponuar material në hapësirë të fabrikës. Dëshmitari ka shtuar se ai i ka pasur faturat por punën e kanë kryer për shitjen e produkteve të vajit dhe yndyrave bimore. Se për kompaninë “Shen” nuk ka dëgjuar ndonjëherë. I njëjti ka deklaruar se për grumbullimin e llamarinës fabrika e vajit nuk ka pasur kompetence sepse ai ka qenë vend me qira dhe kur kërkohet hapësira me qira secili e këqyr hapësirën e vet. Se nuk i kujtohet që qiraxhi ka qenë edhe KFOR-i Amerikan, por e dinë se KFOR-i është sillë aty pranë por nuk i dinë detajet e kontratës dhe nuk ka qenë kompetent i kontratave sepse ato i ka kryer financa. Më tej ka shtuar se kanë pas edhe qiraxhi të tjerë si Elkos, një fabrike e shisheve por emri saj nuk i kujtohej për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Gjithashtu i njëjti ka deklaruar se i kanë bërë mirë edhe shokëve të cilët kanë mundur me lënë mallin aty dhe te nesërmen ta marrin sepse ka qenë hapësirë shumë e madhe. Në lidhje me deponimin e llamarinës në fund dëshmitari ka theksuar se llamarina sa i kujtohej ka qenë në hapësirë të jashtme.

3.8. Dëshmitari R S në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohet që ka dhënë deklaratë për rastin “...” dhe qëndron pranë saj meqenëse në atë kohë të dhënat kanë qenë më të sakta sepse deri tani ka kaluar kohë e gjatë. Se në vitin 2007 ka punuar si vozitës kamioni dhe në atë kohë ka pasur vetëm një kamion me targa ..., duke shtuar se ka kryer punë transporti. Se në vitin 2007 ka qenë në fabrikën “...” në Vushtri por nuk i kujtohet se kush i ka ftuar se aty e kanë bërë një ngarkesë të llamarinës – rrollne dhe me sa i kujtohej dëshmitarit ato ishin të papërdorura dhe pastaj i ka dërguar në Ferizaj – vendi ka qenë rruga që hyn në Ferizaj pa dalur në Shtime në anën e djathtë dhe se ka mundur ajo të jetë fabrika e vajit por nuk i kujtohej saktë

a ka qenë ajo. Sa i përket firmës “..” në Prizren dëshmitari ka deklaruar se atje nuk ka dërguar mall dhe nuk ka dëgjuar për atë firmë. Dëshmitari në fund ka dëshmuar se kur janë ngarkuar në Vushtrri në fabrikën “...” gjatë rrugës kanë pasur flet - përcjellëse me veti dhe të njëjtën e kanë dorëzuar në Ferizaj ku e kanë shkarkuar mallin por kush e ka marr atë flet - përcjellës nuk i kujtohej dëshmitarit sepse ata si vozitësa kishin pasur obligim vetëm për të dorëzuar mallin në vendin e caktuar e pastaj përgjegjësia i kalon atij që e merr dhe në flet – përcjellësen ka përfunduar dëshmitari.

3.9. Dëshmitari B K në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se në vitin 2007 ka poseduar kamion me targa të regjistrimit ... i cili ka qenë në emrin e tij dhe me atë kamion ka bërë transport dhe i kujtohej se ka bërë një herë transport për fabrikën e llamarinave që gjendej në Vushtrri, aty kishte shkuar përmes shokëve që i kishte transportues se dikush i kishte ftuar dhe se aty kane qenë 3-4 persona dhe ishin ngarkuar me llamarinë. Më tej dëshmitari ka shtuar se llamarina kishte qenë rollne dhe nuk e di si mund te quhet por me siguri ka qenë e pa përdorur. Dëshmitari ka deklaruar lidhur me një procedurë kur shkon me u ngarkuar si fillimisht kërkon leje, hyn brenda te portieri, e qetë në peshore dhe prej peshores shkon në ngarkim dhe ngarkim shkarkimi është bërë me lug dhe në momentin që ngarkohet shkon prapë matet në peshore dhe vazhdon aty ku duhet me dërguar ka deklaruar dëshmitari. Sa i përket fabrikës “...” dëshmitari nuk kishte dëgjuar për të njëjtën.

3.10. Dëshmitari Z Z në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se prej vitit 1992 punon me material ndërtimor dhe transport të mallrave, se kanë kamionetë dhe janë pronar, dhe se në atë kohë ka pas biznesin së bashku me axhallaret e tij dhe tani ka biznesin e tij ë transportit dhe firma është quajtur “...” ndërsa pronar ishte axha i tij S Z. Më tej dëshmitari ka theksuar se në Vushtrri kane transportuar llamarinë, pllaka të zeza, material të llamarinës që ka tepruar (jashtë përdorimit) dhe nuk i kujtohej sa here por din se kanë transportuar nga aty. Se kush ka qenë pronar i llamarinës dëshmitari nuk e ka ditur por e din se pagesa për atë transport është bërë, e te cilën llamarinë e kanë dërguar në Prizren por nuk i kujtohej se në cilën firmë te një fabrikë e përpunimit të llamarinës me gypa dhe ulluk. Se fabrika me emrin “...” nuk i kujtonte asgjë e as emri A K. Gjithashtu dëshmitari ka theksuar se sigurisht ka qenë në fshatin Bukosh ku kanë bartur llamarinë, por sa here është ngarkuar me atë mall dhe sa herë ka qenë në fshatin Bukosh nuk i kujtohej. Dëshmitari në fund ka deklaruar se pagesën e transportit e kanë marr aty ku është lënë malli dhe se firmën “...” në atë kohë nuk e ka njohur dhe e njeh edhe tani dhe ka theksuar se kjo firmë merret me llamarinë.

3.11. Dëshmitari N I në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohet që ka dhënë deklaratë në polici dhe qëndron në tërësi pranë saj. I njëjti ka theksuar se ka punuar në fabrikën e llamarinës në Vushtri pra në “...” prej vitit 1987 deri në vitin 2014 me periudha dhe i njëjti ishte referent i shitjes. Se fabrika është marr me traken e parë të zezë ku ajo pastaj është zinkuar dhe se ajo kompani në vitin 2005 ka qenë ndërmarrje shoqërore pastaj kur është privatizuar e kanë marr Bullgaret me sa i kujtohej emri i pronarit ka qenë K K. Se ka qenë i punësuar me kontratë që e ka lidhur me L B ky i fundit kishte qenë drejtor pra i pari i fabrikës, duke shtuar se aty pozitë tjetër nuk ka punuar dhe detyrat e tij si referent i shitjes kishin qenë faturat. Me tutje dëshmitari e përshkruan një proces shitje ashtu që sipas tij kur kishte shkuar blerësi ishin marr vesh me shit, me shku me të me i ngarkuar, me bërë matjen e peshës, kontrollin dhe të njëjtëve i ishte dhënë fatura ku pagesën e kanë bërë në arkë apo përmes bankës pra në dy mënyrat. Tutje dëshmitari ka shtuar se ata kanë pasur shitje brenda dhe jashtë Kosovës në Mal të Zi dhe në Shqipëri. Sa i përket dy dëftesave me numër 95/2017 dëshmitari ka deklaruar se ajo dëftesë është lëshuar në arkë që ja ka dhënë menaxheri F R dhe më pastaj ka shkuar në arkë i ka paguar dhe vlera kishte qenë 27,700.00 euro, e cila ishte bërë në emër të “..”-it të cilën e kishte paguar dhe ja kishte kthyer dëftesën si shitje e cila kishte qenë shitje. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se çka ka kërkuar blerësi i kanë shkruar në letër dhe i kanë ngarkuar në bazë të sasive dhe të gjithave ku pastaj është bërë fatura dhe kjo procedure shkon në koordinim me menaxherin ku varësisht njeri e ka nis pastaj ka shkuar pas kamionit e tjetri është marr me fatura dhe nuk ka pasur njohuri se nga fabrika Llamkos ka dal mall pa destinacion.

3.12. Dëshmitari M S në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohej që ka dhënë deklaratë në polici dhe ka qëndruar pranë saj. Duke shtuar se ka punuar me transport në vitin 2007 dhe ka poseduar kamion të markës Volvo por targat nuk i kujtoheshin dhe kamionin e kishte pasur të regjistruar në emrin e tij personal se ai kamion ishte për të kryer transport me pagesë. Se në firmën “..” kishte qenë ai dhe një tjetër shofer, ku me kamionin e lartpërmendur ka transportuar llaster – llamarinë ku ajo llamarinë nuk i kujtohej se në çfarë gjendje ka qenë. Dëshmitari tutje ka shtuar se kishin hyrë i kanë marr dhe kanë dal dhe se shumë herë kishin ngarkuar edhe tjetër llaster por kryesisht kishte qene e rrumbullaket dhe të njëjtën e kishin dërguar në Prishtinë por nuk i kujtohej se në cilën firmë. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se pagesat janë bërë pasi e kanë shkarkuar mallin dhe paratë i kanë marr të gatshme. Sa i përket firmës “...” me pronar A K dëshmitari ka theksuar se nuk ka dëgjuar për të njëjtën. Pas

ballafaqimit të deklaratës së dhënë në polici nga kryetari i trupit gjykues dëshmitari është përgjigjur se nuk i kujtohet a ka qenë edhe në “Shen” sepse nuk kishte vozitur vetëm ai.

3.13. Dëshmitari F R në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: në pyetje të prokurorit të shtetit se a keni dëgjuar për firmën “...” i njëjti është përgjigjur citat “po ka diference llamkos dhe lumko llamkos, dhe pas privatizimit ka qenë ndërmarrja “E Re Llamkos” dhe unë kam punuar në atë ndërmarrje prej tetor 2005 deri korrik 2007 si menaxher i shitjes. Kjo” ndërmarrje e re Llamkos” ka qenë ndërmarrje që ka bërë përpunimin e llamarinës dhe e ka zingur, pastaj e ka qit në shitje si llamarinë të zinguar dhe prej saj kemi punuar prodhime të ndryshme ulluk, mbuloja të kulmit.. Unë kam punuar si menaxher i sektorit të shitjes dhe departament i shitjes është departament kryesor për ndërmarrje prodhuese dhe obligimet e mija kanë qenë me i përcjellë kontratat ndërkombëtare dhe vendore në bazë të kërkesave të blerësve që kemi dhënë urdhra për zingim çka ka kërkuar blerësi, me përcjelle prodhimin përmes departamentit të kontrollit të cilësisë a po plotësohen kushtet dhe a është ai prodhim i nivelit që e ka lyp blerësi me kualitet që me muajt me përcjellur për shitje, dhe po thujse kam pasur barrën kryesore, atje është departamenti i prodhimit, kontrollit teknik e drejtorit. Shitja është kryer përmes kontratave paraprake dhe në bazë të tyre është dashur ti përmbahemi atyre kontratave. Shitje ka pas edhe brenda e jashtë Kosovës dhe shitja është bërë me kontrata përveç atyre të imëta, dhe për vlera të mëdha ka shkuar me kontrata dhe pagesa ka qenë e obligueshme për ndërkombëtare dhe janë bërë përmes arkës dhe bankës. Periudhën që kam punuar unë prej tetor deri mars 2007 ka qenë L B prej fillimit prill deri korrik kur e kam lëshuar ka qenë B A”. Më pastaj ka shtuar se kontratat gjithmonë ishin nënshkruar prej drejtorit gjeneral me aprovim të pronarit të Sofjes së Bullgarisë apo kryesuesit të bordit të “Llamkos” që kishte qenë R M. Sa i përket pagesës në vlerë prej 487,176.93 € ku bëhej fjalë që “Llamkos” kishte shitur për firmën “Shen” dëshmitari ka deklaruar se bëhet fjalë për mall, pra janë shitur llamarina të cilat kur shtrëngohen bëheshin si rollne që quhej “gubina”, e cila kishte një vlerë të caktuar me çfarë peshe dilte - secila godinë të cilat e kanë pasur peshën dhe dimensionin e vet dhe ka pas kontratë me shkrim e cila kishte qenë e lidhur përmes përfaqësuesit të firmës “Shen” dhe drejtorit gjeneral dhe për vlerën e lartcekur me aq sa i kujtohej dëshmitarit e njëjta nuk është plotësuar por vetëm është paguar një pjesë dhe blerësi kishte paguar 27,700.00 euro, ndërsa paratë ishin dorëzuar në arkë dhe kishin hyrë në ndërmarrje. Sipas dëshmitarit nuk ka njohuri nëse kishte pasur pagesa të tjera në periudhën derisa kishte punuar i njëjti dhe më vonë kishte ndodhur shkatërrimi i bordit dhe drejtorit gjeneral duke ardhur drejtor dhe bord i ri e si drejtor kishte qenë B A.

Sa i përket menaxhimit të arkës të njëjtën e kishte menaxhuar departamenti i financave të cilët ishin përgjegjës për arkën për mjete financiare gjithashtu edhe pronari e drejtori. Në lidhje me faturën me numër ... të dt.17.11.2006 në të cilën behej fjalë për shumën prej 125,430.00 € dëshmitari ka theksuar se “..” asnjëherë nuk i kanë shitur mall. Në pyetjen e mbrojtësit të pandehurit L B, dëshmitari ka deklaruar, citat *“më duket se shpjegova obligimi im ka qenë shitja e materialit i cili është përgatitur dhe ka qenë i gatshëm për shitje. Ne kemi pasur për 15 muaj rreth 60 mijë tonë llamarinë e kemi procesuar dhe kjo ka shkuar përmes departamentit të sektorit të shitjes ku unë kam qenë menaxher, ku prej ardhjes së materialit, çelikut të zi – apo full hard (ashtu është quajtur), prej atij momentit në bazë të kontratave që i kemi pas unë kam qenë përgjegjës me i dhënë urdhrat për prodhim, që blerësi ka kërkesa të ndryshme për material, ka trashësi dhe gjerësi të ndryshme të llamarinës, ka sasi të ndryshme të zingut, zigimi mundet me qenë i ndryshëm, a ka mu plastifikuar ai më vonë, apo ka me u përdorur si llamarinë e zingume me vizllimë, të gjitha këto kërkesa të blerësve që janë definuar në kontratë pavarësisht jashtë apo brenda kanë shkuar në harmonizim me departamentin e kontrollit dhe të gjitha si; llagerimi – deponimi, pra depozitat e materialit të gatshëm kane qenë nën mbikëqyrjen e departamentit tonë që me ditë çdo moment ku është për cilin blerës pastaj që mos me pas telashe gjatë ngarkimit”*. Më tej ka shtuar se ka pasur kontrata vendore dhe ndërkombëtare ndërsa kushtet e pagesës i kishte caktuar pronari e ndërsa dëshmitari kishte qenë i obliguar me të tjerët me prodhuar material. Dëshmitari më tej ka shtuar se kishte ndodhur që pagesat nuk ishin kryer në “...” kur ka pasur marrëveshje me paguar në Bullgari gjë për të cilin i kishin njoftuar dhe nga ana tjetër ishin furnizuar prej pronarit me lëndë të parë.

Sa i përket raportimit të prodhimit dëshmitari ka deklaruar se raporti i prodhimit çdo mëngjes ju ishte dërguar nga drejtori teknik që kishte qenë përgjegjës për prodhim dhe janë përcjellë pronarit, ndërsa të shitjes në baza ditore i ishin dorëzuar edhe një ekipit Bullgar që ishte prezent në fabrikë dhe ata si departament i shitjes kishin raportuar në baza ditore dhe komplet shitja kishte shkuar edhe si raportim mujor te pronari ku përveç raportimeve me shkrim dëshmitari gati çdo muaj kishte shkuar në Bullgari me raportuar për punën e afarizmit të ndërmarrjes. Me pastaj dëshmitari ka shtuar se si departament i shitjes nuk kishte pas asnjë obligim ndaj AKP-së për afarizmin e tyre e as nuk ju ishte kërkuar gjithashtu as nuk kishin qenë në monitorim sepse kishin vepruar si ndërmarrje private ku shit blerja kishte qenë kompetence e tyre pa pasur mbikëqyrje nga AKP. Dëshmitari më tej ka deklaruar se ka pasur raste kur ishte shitur mall pa pagesë gjatë kohës sa kishte punuar ai dhe ajo kishte qenë si veresi - borxh gjithmonë me urdhër të pronarit dhe të kryetarit të bordit R. Gjatë periudhës sa kishte punuar i njëjti asnjëherë nuk kishte dalë

ndonjë mall pa flet dërgesë apo dokumentacione dhe kjo nuk kishte ndodhur as me kamionë e as me trena duke theksuar se kishin pasur edhe tren prej 16-17 vagona të cilët ishin ngarkuar. Sa i përket furnizimit me shumicë të firmës “Sunguri” dëshmitari ka deklaruar se ndërmarrja “Sunguri” në fillim ka pasur të drejtë me u furnizuar nga ndërmarrja e tyre e pastaj disa mosmarrëveshje të tyre për kualitetin e llamarinës dëshmitari e kishte eliminuar kompaninë “Sunguri” si blerës direkt në fabrikën “Llamkos” dhe gjatë kohës sa i njëjti kishte qenë drejtor i shitjes firma “Sunguri” nuk kishte pasur të drejtë me blere llamarinë as produkte të llamarinës me vendim të vet dëshmitarit. Në pyetje të gjykatës se për pagesën në vlerë prej 27,2700.00 euro e cila është bërë prej ndërmarrjes “Shen”, dëshmitari është përgjigjur, citat *“këtë pyetje e kam pas edhe në hetuesi, sipas N I që thotë se i ka marr paret në zyre te unë kjo ka ndodhur shumë shpesh, nëse ka ardhur blerësi dhe nuk e ka gjetur arkëtarin ose kanë dashur me u taku me mua, dhe unë e kam thirrë N I dhe i kam thënë shtini në arkë, ato para janë deponuar në arkë të firmës dhe një kopje i është dorëzuar atij që i ka pruar të hollat dhe me udhëheq ndërmarrje prej 400-500 punëtor është bukur aktivitet i madhe dhe duhet me pas mjete shume financiare dhe ne kemi marrë avans prej blerësve dhe më vonë i kemi kompensuar me material”*. Më tej ka dëshmuar se kërkesa e firmës Shen-it për 600 ton (T) ka qenë si kërkesë e vetme meqenëse të dytën nuk ja kanë lejuar për arsye se nuk e kishte bërë pagesën por do ja lejonin vetëm nëse do të kishte ndodhur me urdhrin e R. Duke theksuar se ai ka pasur obligim drejtpërdrejtë me ju përgjigjur drejtorit gjeneral pra të pandehurit L B për raportimet në baza ditore por se ka raportuar edhe në Bullgari, e që pozita e dëshmitarit kishte qenë që të kujdesej që çdo shitje dhe prodhim që ishte bërë të jetë nën kujdesin e tij se çdo shitje që kishte ndodhur nuk ishte lëshuar pa pagesë vetëm kur kanë pranuar urdhra e që për çdo shitje që ishte bërë dëshmitari si menaxher ka dorëzuar raportin e shitjes të njëjtën ditë kur ishte kryer një shitje të cilat raste ishte informuar edhe pronari dhe ekipi në Bullgari.

Në lidhje me dërgesën për shumën prej 457,176.93 euro për ndërmarrjen “Shen” ka e njëjta është realizuar për dy apo tre ditë meqenëse ishte sasi e madhe, duke shtuar se ka pasur kompetenca me eliminuar ndërmarrje siç kishte vepruar me ndërmarrjen “Sunguri” meqenëse ishte blerës i vogël, ndërsa “Shen”-i me porosinë e lartcekur është llogaritur tek blerësit e mëdhenj. Në pyetje të mbrojtësit dëshmitari ka deklaruar se ekipi nga Bullgaria ka qenë komplet prezent, në mesin e tyre kishte ekspert të prodhimit të kontrollit të cilësisë, shërbimi i cili i ka raportuar kompanisë bullgare për blerje e shitje që vet ata i kishin furnizuar me informata atë pjesë të stafit dhe sa i përket stafit bullgar ka theksuar se të njëjtit kanë qenë të instaluar si të përhershëm e që ditën e premte kane shkuar dhe ditën e diele apo të hënë ishin kthyer.

3.14. Dëshmitari Sh P në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se i kujtohej qe ka dhënë deklaratë në polici para shumë kohe duke theksuar se qëndron pranë saj. Më tej ka shtuar se në vitin 2007 nuk ka punuar por për firmën “Bajgora” ka dëgjuar për të cilën firmë kishte punuar si vozitës i kamionit ku aty kishte punuar me pagë. I kujtohej se si punëtor i asaj firme kishte qenë në firmën “Llamkos” në Vushtrri dhe ishte ngarkuar me mall, llamarinë. Dëshmitari ka shtuar se atë mall e ka dërguar në Shqipëri, Kosovë ndoshta edhe në fshatin Bukosh por nuk i kujtohej saktë gjë për të cilën e kishte paguar firma “Bajgora.” Më tej ka theksuar se kur ka shkuar me ngarkuar mall nuk i kujtohet se si ka qenë procedura, gjithashtu i kujtohej se edhe diku në Prizren ka dërguar mall. Dëshmitari në fund ka deklaruar se nuk e din sa herë është ngarkuar për në “Llamkos”.

3.15. Dëshmitari Sh S në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: që L B e njeh dhe kishte qenë partner në kompaninë “ELM Group” e cila kompani ka qenë e përbërë prej katër aksionareve si: E Z, M B, L B dhe vet dëshmitari, ndërsa drejtor kishte qenë L B. Kompania ishte regjistruar në vitin 2009, kompani e cila faktikisht punon por i njëjti nuk është më aksionar sepse kishte shitur aksionet për një kompani tjetër, ndërsa ka shtuar se as L B nuk ka më aksione aty. Sipas dëshmitarit L B kishte qenë menaxher i përgjithshëm dhe kishin pasur të hapur llogari bankare në mënyrë që përfitimi të derdhej aty pra fillimisht në bankën TEB e pastaj në NLB Bankë, duke shtuar se beson se gjithë aksionaret kane pasur qasje në mjetet që ishin derdhur në banka. Duke vazhduar me përgjigje, citat *“pasi kam dhënë deklaratë në polici e kam pyetur vëllain dhe sqarimi ka qenë se kane qenë dy deponime, ka qenë pjese e deponimit si kapital fillestar i aksionareve, edhe deponimi tjetër janë marr në formë të huazimit nga aksionareve për pagese të doganës që janë marr nga kompania”*. Më tej ka shtuar sa i përket personit me emrin M K që me datë 25.08.2009 kishte deponuar një shumë në vlerë të madhe dëshmitari nuk e kishte ditur kush ka qenë këtë e kishte mësuar nga vëllai i tij i cili i kishte treguar se ajo është gruaja e L por se vet nuk e ka njohur dhe pastaj kishte kuptuar se në llogarinë e firmës së tyre ishte bere pagesa nga M, të cilin deponim e kishte bërë për investim të aksioneve. Më tej ka theksuar se L B më parë nuk e ka ditur se çka ka punuar. Në pyetjen e të pandehurit L B dëshmitari është përgjigjur se shuma prej 35,000.00 euro ka qenë për TVSH dhe për doganë dhe koha kur i pandehuri L B ka dalur si aksioner kishte qenë dhjetor i vitit 2011 me arsyen se kompania kishte operuar humbje. Dëshmitari ka shtuar se taxi ka funksionuar me emrin “London Taxi” dhe se investimi ishte prej 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) euro nga secili aksionar duke supozuar se ka qenë investim dhe se ndërkohë ata kishin marr edhe kredi për me muajt me i mbuluar shumen

prej 250,000.00 (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) euro dhe kreditë tjera kishin vazhduar ndërkohë, sepse sa i përket investimit fillimisht i kanë marr 250,000.00 € (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) kredi, e pastaj duke marr edhe tjera kredi, njëherë me i mbuluar shpenzimet, si dhe për investime, sepse fillimisht kishin startuar me 15 vetura dhe ndërkohë kanë marr edhe tjera.

Dëshmitari gjatë dëshmisë së tij ka shtuar se nuk e dinte saktë sa kishte kushtuar një veturë, sepse ato kishin qenë specifike për atë kohë nuk e dinte se a kanë qenë 27,000.00 euro apo 28,000.00 euro. Zyra e kompanisë sipas dëshmitarit fillimisht kishte qenë e regjistruar në rr “...” e cila kishte operuar si bazë dhe varësisht nga kërkesat ishte ndërruar lokacioni, një kohë kishte qenë tek lagja “Lakërishtë” e pastaj te rrethi me flamur. Numri maksimal i makinave kishte qenë 30 por nuk kishin operuar me numrin maksimal të veturave sepse kishin qenë në prishje duke shtuar se më pastaj kishin marr edhe vetura tjera si Nissan.

Dëshmitari ka theksuar se nuk është marrë me menaxhimin e kompanisë por ishte marrë vëllai i tij, ndërkohë dhe sa i përket shumës së investimit të parë prej 250,000.00 euro dëshmitari ka deklaruar se për atë shumë është marr kredi në emër të kompanisë, të tjerat nuk i ka ditur nga por ka shtuar se shpesh kanë shfrytëzuar edhe over drafte. Sa i përket vendimeve në kompani i njëjti ka thënë se ai vet personalisht nuk është marr me atë çështje, është menaxhuar nga L B dhe se ai i ka ndihmuar ndonjë pjese legale - ligjore, ndonjë kontratë apo ankese e që pjesën tjetër nuk është përfshirë. Dëshmitari krejt në fund ka deklaruar se shuma prej 35,000.00 € (tridhjetë e pesë mijë euro) e deponuar nga L B nuk ka pas shumë të dorëzuar nga ai dhe se të gjitha informatat i ka marr nga vëllai i tij.

3.16. Dëshmitari mbrojtjes E Z në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar se; L B e ka njohur që nga viti 2008 si drejtor menaxhues në agjencinë “..”. Se ka njohuri për themelimin e ELM Group SH.P.K, e njëjta ka qenë e themeluar nga viti 2009 nga dëshmitari E Z, M B, L B dhe Sh S ku ideja për themelim ka qenë taxi – pra taxi “London”, se përgjegjësinë për financa e ka pasur vet dëshmitari në kuadër të katër bashkëpronarëve të lartcekur. Se i kujtohej deponimi i bërë ne emër të L B në llogari të “ELM group” i datës 20.12.2009 në shumë prej 35,000.00 euro (tridhjetë e pese mijë euro) e që ai deponim ishte bërë nga vet Luani sepse vet dëshmitari me M B atë ditë kishin qenë në Aeroportin e Prishtinës duke bërë pagesën për veturat dhe mjetet që i kishte deponuar L B kishin qenë mjete të P Z, M B dhe B S – vëllait të Sh, ku ka shtuar dëshmitari që ai dhe M B i kanë dhënë nga 13,000.00 € (trembëdhjetë mijë euro) secili veç e veç, ndërsa B i kishte dhënë 9,000.00 euro (nëntë mijë euro), sa i përket deponimit të shumës prej

35,000.00 € dëshmitari ka deklaruar se ato nuk kanë qenë të L B por kane qenë të vet dëshmitarit, M dhe vëllait të Sh – pra B, e që ato para dëshmitari ja kishte marrë nënës dhe axhës së tij e të cilat ja kanë dhënë kompanisë dhe L B kishte bërë deponimin për kompaninë.

Dëshmitari ka deklaruar se sa i përket borxheve që i kanë marrë nga familjaret, ka thënë se para tre vite e kishte paguar kredinë që e kishte marrë dhe se nuk kishte mundur që ta nxjerrte investimin e as të fitonte.

Në pyetjen e gjykatës citat *“ju thate se i keni prit 15 vetura një kohë të gjatë dhe e keni ditur shumën e tyre se sa ka qenë çmimi, duke marr për bazë ti që je marr me çështje financiare pse është dashur me prit momentin atë ditë kur e ke ditë që shumën e parave nuk e keni pasur ?”*, dëshmitari është përgjigjur, citat *“nëse kthehesh prape katër muaj më herët gjeni deponime edhe 2 euro për me bere pagesën për avancin, sepse unë nuk jam financier dhe jam dizajner dhe ja kam huqur në kalkulimin e shumës së nevojshme pra për shumën 35 mijë euro. Nuk kam mundur me llogaritë sa mjete është dashur me qene sepse kemi qenë në stres të kohës, dhe e kemi pare që nuk po na dalin paratë (për pagesën e doganës për vetura) dhe e kemi thirre Luanin me bërë pagesën që me mbyllë atë cikël, dhe ne gjithmonë kemi qenë në kërkesë të parave, dhe neve edhe miqtë na kane ndihmuar dhe kompania në përgjithësi ka afaruar keq dhe non-stop kemi pas nevojë për mjete shtesë”*. Më tutje duke deklaruar se i kujtohej që kanë paguar doganë për veturë çmimin prej 5555 euro dhe se Luani si bashkëpronar por edhe bashkëpronaret tjerë të ndërmarrjes kanë pasur qasje në financa.

3.17. Dëshmitari i mbrojtjes G G në shqyrtimin gjyqësor mes tjerash ka deklaruar: se në Kosovës ka qenë që prej muajit Prill 2000 me disa shkëputje e që gjatë asaj periudhe arsyeja e qëndrimit në Kosovë kishte qenë puna dhe kishte punuar në organizatën A Bar A, ndërsa prej vitit 2003-2009 ka punuar si këshilltar ligjor ndërkombëtar në administratën e UNMIK-ut. Nga viti 2009-2012 ka qenë i angazhuar si ekspert në asistencë teknike e financuar nga Bashkimi Evropian, prej vitit 2012-2018 ka qenë i angazhuar pranë kompanisë Deloit e cila në kontratë me AKP ka qenë e angazhuar për mbarëvajtjen e procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, pastaj deri në mars të vitit 2022 ka qenë i angazhuar për kompaninë avokatore e që në momentin e dhënies së deklaratës (aktualisht) ishte i angazhuar në projekte asistence teknike përsëri me Qeverinë e Kosovës. Në pyetjen e mbrojtësit të pandehurit L B av.R G *“në këtë dokument (letër) për të cilën po flasim ndër tjera thuhet “ashtu siç është theksuar edhe në përgjigjen e drejtorit menaxhues të AKP-së të dt.08.06.2018 i dëmtuar nga borxhet e bizneseve “Geni Trade” dhe “Shen” ka qenë*

ndërmarrja e re “Llamkos” sh.p.k, respektivisht pronari i saj pas privatizimit të vitit 2005 Kremikovxi AD nga Bullgaria, ndërmarrja e RE “Llamkos” sh.p.k ka operuar në treg dhe ka lidhur marrëveshje me këto dy operator si kompani private marrëdhënia e saj me “Gini Trade” dhe “Shen” ka qenë marrëdhënie tregtare mes kompanive private që kanë krijuar të drejta dhe detyrime të caktuara në kuadër të operimit privat në treg. Ndërmarrja e RE “Llamkos” sh.p.k ka operuar si kompani private e pavarura deri me 28 shtator 2009. Pyetja është a qëndron kjo a qëndron pranë këtij konstatimi edhe sot?”, dëshmitari është përgjigjur citat “po, pasi pa u thelluar në detaje që përmendet por sigurisht se në atë kohë kam pas gjithë informacionin e nevojshëm për të pasqyruar gjithë atë që kam pasqyruar dhe sot nuk kam mundësi të verifikojë gjithë atë në detaje. Por sigurisht se është saktë”.

Dëshmitari G G gjatë dëshmisë së tij në pyetjet e mbrojtjes së të pandehurit L B ka mbështetur shkresën e përpiluar nga ana e tij në cilësinë e kryesuesit të “Neëco Llamkos Sh.P K. (në Likuidim) në të cilën thuhet “se marrëdhëniet tregtare të krijuara prej korrik 21 – 05 kur u privatizua Llamkos deri me 28 Shtator 2009 kane qenë marrëdhënie sovraane të një kompanie private, me kompani tjera private, dhe çdo e drejte apo detyrim i krijuar në këto marrëdhënie i është nënshtruar rregullave të tregut mes operatoreve privat. Kësi soji ndërmarrja e RE Llamkos shpk është dëmtuar nga borxhet e Gini Trade dhe Shen apo edhe nga borxhet e tjera të bizneseve me të cilat menaxhmenti i kësaj ndërmarrje kish hy në marrëdhënie tregtare dhe nuk ka arritur të arkëtoj të ardhurat që rrjedhin nga ato marrëveshje biznesi.” Më tej dëshmitari ka shtuar se ndërmarrja e “Re Llamkos” dhe “Llamkos” kanë pas dy autoritete te likuidimit të veçanta, letra që ka nënshkruar dëshmitari lidhet vetëm me ndërmarrjen e ndërmarrjes së “Re Llamkos” se atë e kishte nënshkruar në emër të likuidimit ndërsa sa i përket pasazhit në letër arkëtimi lidhet me futjen ne arkën e kompanisë të borxheve që partnerët e saj tregtar kane ndaj saj dhe se në atë letër nuk e ka shkruajtur se “Llamkosi i Ri” ka pas detyrime, letra lidhej me detyrimet e të tretëve ndaj ndërmarrjes së Re “Llamkos”. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar sa i përket periudhës 2005 e deri në vitin 2009 kur ka ndodhur privatizimi gjatë asaj periudhe ndërmarrja ka qenë në pronësi private dhe si çdo ndërmarrje ndaj të cilës shkaktohet dëm i mundshëm - i dëmtuar është pronar i asaj ndërmarrje kjo nuk ka të bëjë me faktin se pronari është person fizik apo juridik. Kushdo që ka qenë pronar i asaj ndërmarrje në atë periudhë të caktuar është edhe i dëmtuar gjatë dëmit që është shkaktuar në atë periudhë. Në pyetjen e gjykatës dëshmitari është përgjigjur, citat “autoriteti i likuidimit të kësaj ndërmarrje apo të gjithë ndërmarrjeve në likuidim të ndërmarrjeve shoqërore që administrohen nga AKP rreth 600 prej tyre kane pas kompetenca te detajuara ne shtojcën e ligjit të AKP dhe këto kompetenca është shqyrtimi kërkesave kreditore

apo pronësore gjatë procesit të likuidimit, ndjekja e çështjeve gjyqësore që mund të jene në zhvillim apo hapja e shqyrtimeve gjyqësore nëse ka nevojë, përpilimi i raporteve në likuidim deri në momentin e dorëzimit në gjykatë për raportin përfundimtar për shpërndarjen e mjeteve të arkëtuara si pasojë e shitjes së aseteve gjatë proceseve të likuidimit të kreditorëve apo pronarëve e vërtetuar nga proceset, çka shënon edhe në mbylljen e procesit të likuidimit”. Më tej ka theksuar se ai vet ka qenë autoritet i likuidimit për ndërmarrjen e “Re Llamkos” sepse ka qenë kryesues i 200 autoriteteve të likuidimit dhe se ndërmarrja “...” kishte hy në likuidim më përpara se sa ndërmarrja e “Re Llamkos” kjo për shkak sepse ndërmarrja e “Re Llamkos” kishte qenë ndërmarrje e filluar në procesin e privatizimit të ndërmarrjes “Llamkos” dhe ky ka qenë një rast jo i zakonshëm ku në kuadër të kompetencave të bordit të AKP janë tërhequr aksionet në ndërmarrjen e “Re Llamkos” dhe është rikthyer në pronësi shoqërore.

Si arsye e tërheqjes së aksioneve dëshmitari ka deklaruar se ajo ka ndodhur pasi në kontratën për privatizimin e një ndërmarrje shoqërore ka kushte të caktuara që duhet të përmbushen prej blerësit në privatizim dhe këto kushte në shumicën e rasteve janë të afatizuara dhe në kontratë në shumtën e rasteve kompetenca e agjencisë është të tërheq aksionet për mos plotësimin e kushteve brenda afatit të caktuar duke thënë se kjo gjë beson të ketë ndodhur në rastin konkret ku brenda afatit për të përmbushur detyrimet. Pronar i kompanisë është blerësi i cili figuron edhe në ARBK e që në rastin konkret me sa i kujtohej dëshmitarit kishte qenë një kompani bullgare.

3.18. Eksperti - dëshmitari Xh K në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: se ka ekzaminuar fillimisht gjitha shkresat e lëndës dhe ka dhënë opinionet në lidhje me të njëjtat. Eksperti në fjalë në lidhje me ekspertizën e ekspertës nga policia ka theksuar se kjo ekspertizë është marr me përshkrimin e transaksioneve financiare (hyrjeve - daljeve) e jo me përshkrimin dhe konstatimin e provave që mbështeten ato transaksione sepse çdo transaksion – pagesë duhet të mbështetet në dokumentacionin mbështes andaj eksperti i caktuar nga gjykata në rastin e ekspertimit të provave financiare i ka ekzaminuar dhe gjetur prova përcjellëse mbi bazën e të cilave janë realizuar transaksionet financiare. Më tej ka shtuar se qëndron konstatimi i dhënë në ekspertizë se AKP nuk është palë e dëmtuar sepse me procedurat e shitjeve mbi bazën e kontratave të shitjes së ndërmarrjes në fjalë janë vënë kushtet dhe ato kushte i kishte administruar vet AKP, ku ndërmjet proceseve të auditimit të shitjes së parë dhe të dytë është konstatuar që kompanitë blerëse nuk i kanë përmbushur në tërësi obligimet e parapara me dispozitat kontraktuale andaj mbi bazën e të gjeturave të auditimit të AKP dhe bazuar në të drejtat të saja ligjore i ka tërhequr aksionet dhe kompaninë e shitur e kishte kthyer në kuadër të AKP-së. Tutje eksperti ka deklaruar se kompania

e para shitur nuk ka mundur assesi të dëmtohet vetëm ka mundur ti rritet vlera pasi që blerësi i ka deponuar 4 milion e 151 (4,151,000.00) euro, ndërsa blerësi i dytë 6 milion e 500 (6,500,000.00) euro, ku kjo do të thotë që si total prej 10,000,000.00 € (10 milion euro) që i ka marr AKP. Eksperti tutje ka shtuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me dështimin e blerësve dhe realizimin e obligimeve sipas kontratës së shit - blerjes.

Në pyetje të gjykatës eksperti ka deklaruar se pasoja ka qenë vetëm për blerësin dhe të gjitha ato investime që i ka bërë i kanë dështuar dhe i kanë shkuar huq dhe në shitjen e dytë AKP e ka penalizuar blerësin e dytë në emër të dështimit të kushteve ligjore me kamatë në vlerë prej 1 milion e 700 mijë euro (1,700,000.00) dhe blerësin e dytë e ka penalizuar për shkak të dështimit të kushteve që i ka marr si obligim sipas dispozitave kontraktuale dhe që nuk lidhej me privatizimin e parë. Shuma e privatizimit të parë 4 milion e 151 (4,151,000.00) euro është e ndaluar dhe ekziston në llogarinë e AKP ku kompania ishte shitur për atë vlerë dhe ato kanë qenë humbje për shkak të paaftësisë së tyre për ti përmbushur obligimet kontraktuese. Eksperti tutje ka shtuar se në bazë raporteve të auditimit si në rastin e shitjes së parë dhe të dytë me asnjë dispozitë nuk konstatohet se ka dëm kompania e shitur por ka mos përmbushje të obligimeve kontraktuale.

Eksperti ka sqaruar se sa i përket transaksionit në xhirollogarinë e L B ku janë deponuar 100,000.00 € (njëqind mijë euro) nga D M ka pasur të bëjë me një huazim nga huazuesi i mjeteve i cili ka bërë një transfer në llogarinë bankare, tutje ka shtuar se huazimet e tilla kanë qenë prezentë në shoqërinë Kosovare dhe janë të ligjshme, qofte me persona fizik apo juridik dhe sipas ekspertit ai transfer ka qenë plotësisht i ligjshëm pra huazim ku huamarrësi ka qenë i obliguar që në kohë të caktuar të bëjë kthimi i huas.

4. Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

- Urdhërpagesa nr. e datës 11.10.2005 në vlerë prej 10.228,65€.
- Transaksioni bankar përmes Raiffeisen Bank nga “..” tek “..” i datës 27.10.2005 në vlerë prej 13.000,00€.

- Transaksioni bankar përmes Raiffeisen Bank nga “..” tek “..” i datës 16.09.2005 në vlerë prej 17.000,00€.
- Transaksioni bankar nga “.” tek “..” i datës 15.11.2005 në vlerë prej 10.000,00€.
- Transaksioni bankar nga “..” tek “..” i datës 15.11.2005 në vlerë prej 10.000,00€.
- Pasqyra bankare e datës 07.10.2005 me të cilën shihet tërheqja nga xhirrollogaria e “..” me datë 16.09.2005 shumën prej 17.000,00€; me datë 23.09.2005 shumën prej 19.340,00€; me datë 26.09.2005 shumën prej 31.050,00€ me datë 28.09.2005 shumën prej 46.575,00€ dhe me datë 13.10.2005 shumën prej 19.900,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 290/06 e datës 09.10.2006 në shumë prej 45.000,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 339/06 e datës 15.11.2006 në shumë prej 9.000,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 342/06 e datës 17.11.2006 në shumë prej 8.000,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 300/06 e datës 12.10.2006 në shumë prej 18.000,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 306/06 e datës 13.10.2006 në shumë prej 30.000,00€.
- Dëftesa për pagesë përmes arkës së “...” për “...” nr. 307/06 e datës 17.10.2006 në shumë prej 15.430,00€.
- Faturat në të cilat shihet se biznesi “...” e ka furnizuar ndërmarrjen “..” me naftë, gazë dhe mazut: Fatura nr. 53 e datës 30.09.2005; Fatura nr. 54 e datës 04.10.2005; Fatura nr. 55 e datës 30.09.2005; Fatura nr. 56 e datës 02.10.2005; Fatura nr. 57 e datës 19.09.2005; Fatura nr. 57 e datës 06.10.2005; Fatura nr. 58 e datës 30.09.2005; Fatura nr. 59 e datës 30.09.2005; Fatura nr. 60 e datës 30.09.2005; Fatura nr. 62 e datës 16.10.2005; Fatura nr. 63 e datës 25.10.2005; Fatura nr. 64 e datës 28.10.2005; Fatura nr. 65 e datës 23.10.2005; Fatura nr. 66 e datës 26.10.2005; Fatura nr. 67 e datës 26.10.2005; Fatura nr. 68 e datës 30.10.2005; Fatura nr. 69 e datës 21.09.2005; Fatura nr. 70 e datës 21.10.2005 dhe Fatura nr. 71 e datës 21.10.2005.
- Gjendja në dokumentin Ditar për biznesin “...” për vitet 2005 – 2006 – 2007.
- Lista e furnitorëve të ndërmarrjes “...”.
- Informatat nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK – MTI) për biznesin “...”.

- Informata nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK – MTI) e datës 24.10.2012 për bizneset “...” dhe “...”:
- Raporti i ATK-së nr. i datës 29.06.2012
- Të dhënat e pranuar nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Obiliqit e datës 27.03.2013.
- Të dhënat e pranuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Pronë, Kadastër Gjeodezi dhe Mjedis në Komunën e Ferizajt e datës 28.03.2013;
- Fatura nr. 2502/12 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 12.100,85€
- Fatura nr. 2502/13 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.633,95€
- Fatura nr. 2502/14 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.873,65€
- Fatura nr. 2502/15 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.447,00€
- Fatura nr. 2502/16 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.286.00€
- Fatura nr. 2502/17 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 22.467.55€
- Fatura nr. 2502/18 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.569.87€
- Fatura nr. 2502/19 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 9.998.10€
- Fatura nr. 2502/20 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 15.576.75€
- Fatura nr. 2502/21 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.231.45€
- Fatura nr. 2502/22 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.964.00€
- Fatura nr. 2502/23 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.279.75€
- Fatura nr. 2502/24 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 18.458.65€
- Fatura nr. 2502/25 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.702.15€
- Fatura nr. 2502/26 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.314.34€
- Fatura nr. 2502/27 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.648.16€
- Fatura nr. 2502/28 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 21.395.06€
- Fatura nr. 2502/29 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.817.17€
- Fatura nr. 2502/30 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 18.329.85€
- Fatura nr. 2502/31 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 18.209.10€
- Fatura nr. 2502/32 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 9.845.15€
- Fatura nr. 2502/33 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.690.30€
- Fatura nr. 2502/34 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 13.773.30€
- Fatura nr. 2502/35 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.012.30€
- Fatura nr. 2502/36 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 20.175.88€
- Fatura nr. 2502/37 lëshuar nga “...” për “SHEN” në shumë prej 19.416.60€

- Dëftesa për pagesë nr. 95/06 e datës 06.03.2007 në shumë prej 27.700,00€.
- Raporti i ATK-së, ref. Nr.— NJHT, i datës 03.05.2012 lidhur me pasqyrën e obligimeve tatimore të NTSH “SHEN”
- Kopja e dosjes së firmës “SHEN”.
- Raporti i ATK-së i datës 22.02.2013 lidhur me të dhënat e personit L B dhe bizneseve “Sigma Group LTD”, N.Sh. “NËSE Explorer”, N.P.T. “Prime Oil”, “London Taxi Service” sh.p.k. dhe “ELM Group” sh.p.k.
- Informata Referencë 100/13-NJHT e datës 17.07.2013
- SMS (mesazhet telefonike) të L B, numri i telefonit 044/506-740 të vendosura në CD .
- Ekspertiza Financiare e përpiluar nga ekspertja për çështje ekonomike pranë Policisë së Kosovës DHKEK – DPP Prishtinë, F T e datës 30.01.2017.
- Plotësim i Ekspertizës Financiare e përpiluar nga ekspertja për çështje ekonomike pranë Policisë së Kosovës DHKEK – DPP Prishtinë, F T ref. nr. DHKEK/A/4/16 e datës 22.05.2017
- Përgjigja në Kërkesë për informata e pranuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ref. nr. .. e datës 15.03.2013.
- Përgjigja në Kërkesë për informata e pranuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ref. nr. 06/3-293/2013 e datës 01.07.2013.
- Përgjigja e pranuar nga Drejtoria e Kadastrit, Komuna e Prishtinës, e datës 04.04.2013.
- Të dhënat e nxjerra nga dokumenti “Ditari” për biznesin “Alcon” SHPK për vitet 2005 – 2006 – 2007 – 2008 – 2009.
- Njoftimi nr.145, datë 20.02.2013 me të dhënat e pranuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).
- Njoftimi nr.414, datë 06.06.2013 me të dhënat e pranuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK).
- Përgjigja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e datës 08 qershor 2018
- Përgjigja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e datës 26 qershor 2018
- Përgjigja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e datës 09 korrik 2018
- Raporti policor mbi zbulimin e të dhënave financiare nr.06/3-353/2017 datë 11.12.2017.
- Raporti policor mbi zbulimin e të dhënave financiare ref. nr. 06/3-365/2017 datë 13.12.2017
- Përgjigjeje në kërkesë nr. 06/3-569/2013 protokolluar nr. NJHTI nr. 369/13 datë 03.12.2013 lidhur me bizneset:

- “Alcon” SHPK, me nr. të biznesit ..
- NTSH “Sunguri”, me nr. të biznesit ...
- NTP GP “Metal” SHPK, me nr. të biznesit ...
- Kontrata mbi blerjen e paluejtshmerisë në Nerodime e Epërme. Kontrata e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
- Kontrata mbi shit blerjen e paluejtshmerisë së njëjtë. Kontrata e vërtetuar nga noteri.
- Llogaria Pro Credit Bank për shumën prej 100,000.00 euro
- Letra e kryetarit të bordit të drejtoreshave të ndërmarrjes së re Llamkos, z.R M, në bullgarisht dhe shqip, deklaratë e dhënë para noterit
- Llogaria bankare lidhur me tërheqjen e kredisë së zonjës- bashkëshortes së të pandehurit L B – lidhur me ndihmën për biznesin London Taxi.

5. Mbrojtja e të pandehurve

5.1. Të pandehurit pasi janë udhëzuar me të drejtat dhe obligimet nga gjykata të gjithë janë mbrojtur në heshtje.

6. Fjala përfundimtare e palëve

6.1. Prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës Florije Salihu – Shamolli në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar ka theksuar se nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen, kjo është vërtetuar sipas prokurorisë nga deklaratat e dëshmitarëve dhe provave materiale të administruara. Mes tjerash ka theksuar se nga provat e administruara dhe dëgjimi i dëshmitarëve vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen dhe në veprimet e tyre të kundërligjshme formësohen elementet qenësore gjegjësisht tiparet e figurës së veprës penale dhe gjitha provat që janë administruar janë nxjerr në mënyrë të ligjshme konform dispozitave ligjore andaj mbi bazën e të gjitha të cekurave i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas. Në shqyrtimin e fundit gjyqësor prokurorja është tërhequr nga propozimi për konfiskimin e pasurisë në fshatin Nerodime e Epërme KK Ferizaj, e cila ishte propozuar që të konfiskohet me aktakuzë.

6.2. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar – AKP-së – L S në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale, duke qëndruar pranë kërkesës pasurore- juridike të precizuar të ushtruar në formë të shkruar me datë 11.11.2021, në të cilën kërkesë kanë kërkuar që ti kompensohet dëmi në borxhin e krijuar nga “Gini Trade” për New Llamkos Steel L.L.C në shumën prej 297,742.89 euro si dhe nga NTP “Shen” për New Llamkos Steel L.L.C në shumën prej 459,476.93 euro si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale me kamatë ligjore. Gjithashtu kanë kërkuar të behet konfiskimi i patundshmërisë në Zonën Kadastrale Nerodime e Eperme, Komuna Ferizaj e lidhur me kontratë në shumën kontraktuese prej 6,000.00 €.

6.3. Mbrojtësi i të pandehurit L B – av.Ramë Gashi në fjalën përfundimtare mes tjerash ka deklaruar se; që nga faza e hetimeve e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka dorëzuar prova të cilat dëshmojnë se i mbrojturi i tij për të njëjtën çështje po gjykohej dy here. Duke shtuar se që nga fillimi i hetimeve në këtë çështje penale ka ekzistuar parashkrimi relativ i ndjekjes penale. Gjithashtu edhe ekspertiza e gjykatës ka konstatuar se AKP-ja në këtë çështje fare nuk ka qenë e dëmtuar. Mbrojtësi në fund i ka propozuar gjykatës që në mungesë të provave ta liroj nga akuza të mbrojturin e tij L B për gjitha pikat e aktakuzës.

6.4. I pandehuri L B në tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

6.5. Mbrojtësi i të pandehurit D M– av.Florent Latifaj në fjalën përfundimtare mes tjerash sa i përket të mbrojturit të tij në pikën III të akuzës i ka propozuar gjykatës që ta liroj atë nga akuza në mungesë të provave sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti është kryerës i veprës penale. Se është shpikje ajo e cila është thënë si borxh fiktiv se i mbrojturi i tij nuk ka të bëjë me ndërmarrjen “Shen” dhe se është dikush tjetër pronar, duke shtuar se borxhi nuk është keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi dhe këtë sipas mbrojtësit e ka thënë edhe eksperti financiar Xhevdet Krasniqi. Duke kërkuar në fund që i njëjti të lirohet nga akuza në mungesë të çfarëdo elementi minimal të dyshimit të arsyeshëm.

6.6. I pandehuri D M në tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

6.7. Mbrojtësi i të pandehurit I P – av.Agron Selimaj fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar ku ka theksuar se mbi bazën e provave të ekspertuara me ekspertizë vërtetohet se AKP

nuk ka qenë palë e dëmtuar sepse dëmi i shkaktuar ndërmarrjes së re “Llamkos Steel” sh.p.k e cila ka qenë kompani private në periudhën prej 21.06.2005 e deri me 28.09.2009. Se gjatë gjithë këtij procesi gjyqësor me asnjë rrethanë qofte me prova materiale apo njerëzore nuk është gjetur se i mbrojturi i tij ka qenë pronar i kompanisë “..” se nuk ekziston asnjë lidhje shkakësore apo logjike për ta marrë për bazë pretendimin e prokurorisë se i mbrojturi i tij ka pasur ndonjë lidhmëni me kompaninë “Shen” madje edhe vet organet e drejtësisë e kishin konstatuar si kompani fiktive. Gjithashtu ka theksuar se gjatë gjithë procesit nga 21 dëshmitarët e propozuar nga prokuroria asnjëri nga ta nuk e kanë njohur të mbrojturin e tij të kenë komunikuar apo ndonjë veprim tjetër me atë. E që në tërë procesin gjyqësor asnjë provë, dëshmi apo deklaram nuk ka përmbajtur elementet e nevojshme për të konsideruar veprimet e të mbrojturit të tij si keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi. Se Kodi kërkon që të konsiderohet vepër penale, çdo veprim apo mos veprim që ndonjë mënyrë apo tjetër e shkel ligjin apo rregullat e veprimtarisë afariste, ndërsa në procesin gjyqësor sipas mbrojtësit asnjë ligj, akt nënligjor apo rregull tjetër e veprimtarisë afariste nuk është cekur apo pretenduar se është shkelur nga veprimet e të mbrojturit të tij. Krejt në fund mbrojtja ka kërkuar nga gjykata që në mungesë të elemente objektive dhe subjektive së pretenduar që i mbrojturi i tij të shpallet i pafajshëm.

6.8. I pandehuri I P në tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

6.9. Mbrojtësi i të pandehurit M S– av.Xhafer Maliqi fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar, në të cilën ka theksuar se provat të cilat i referohen të mbrojturit të tij nuk e provuan tezën e akuzës dhe kjo shihej sheshazi në fazën e hetimeve por nuk e dinë se si erdhi deri të faza e ngritjes së aktakuzës, pasi që sipas mbrojtjes mungonte elementi kryesor i ekzistimit të dyshimit të bazuar mirë. Sa i përket ekspertizës së caktuar nga gjykata që është provë kryesore sipas avokatit në fjalë, është vërtetuar pa mëdyshje se në këtë çështje penale AKP-ja nuk ka qenë palë e dëmtuar. Në fund mbrojtësi i ka propozuar gjykatës që bazuar në nenin 363/1.3 gjykata të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza ngase nuk provohet se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

6.10. I pandehuri M Snë tërësi e ka përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke theksuar se nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

7. Gjetjet e Gjykatës.

7.1. Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nën par. 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

7.1.1. Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të tyre, secilës veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, ka arritur tek përfundimit se nuk ka prova të mjaftueshme, me të cilat vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprat të cila i janë vënë në barrë me aktakuzën e ndryshuar të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr 35/2015 të dt.09.10.2019.

7.1.2. Gjykata arsyetimin e këtij aktgjykimi do ta filloj nga dispozita inkriminuese e veprës penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nënpar. 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cila përcakton se; personi përgjegjës që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kryen një nga veprimet në vijim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për ndonjë person tjetër; pika 1.1 krijon apo mbanë fonde të pa lejuara në Republikën e Kosovës ose në ndonjë juridiksion tjetër, pika 1.2 përmes përpilimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme, me bilance të rreme, me vlerësime të rreme, inventarizim apo prezantim tjetër të rremë ose përmes fshehjes së provave në mënyrë të rreme e prezanton qarkullimin e aseteve ose të rezultateve të veprimtarisë ekonomike dhe në këtë mënyrë i vë në lajthim organet drejtuese në organizatën e biznesit gjatë vendim marrjes lidhur me veprimtarin menaxhuese, pika 1.3 nuk i paguan detyrimet tatimore ose detyrimet e tjera fiskale të parapara me ligj, pika 1.4 mjetet me të cilat disponon i shfrytëzon në kundërshtim me qëllimin e tyre të paraparë dhe pika 1.5 në ndonjë mënyrë tjetër e shkel ligjin apo rregullat e veprimtarisë afariste lidhur me tjetërsimin, përdorimin apo menaxhimin e pasurisë. Në paragrafin 2 të nenit 290 është forma e kualifikuar e kësaj vepre penale që ka të bëjë me dobi pasurore e cila tejkalon 100,000.00 euro kryerësi dënohet me burgim prej 1 (një) deri 8 (tetë) vite.

7.1.3. Karakteristika e këtyre keqpërdorimeve është ngase kryerës është personi përgjegjës në organizatën e biznesit apo tek personi juridik i cili merret me veprimtari ekonomike, dhe se të gjitha format e kryerjes së kësaj vepre penale kanë për qëllim përfitimin e dobisë pasurore të kundërligjshme për organizatën e biznesit apo për personin juridik në të cilën është i punësuar ose organizatës tjetër të biznesit ose të personit tjetër juridik tek të cilët nuk është i punësuar, ose realizimi i dobisë pasurore për vete. Të pandehurit janë akuzuar se me veprimet e tyre ia kanë

shkaktuar dëm material Ndërmarrjes së Re “Llamkos”, në favor të ndërmarrjeve “Shen” dhe “Sunguri”, në vlerat të paraqitura si në dispozitivin III dhe V të këtij aktgjykimi.

7.1.4. Dëmi – pra për të ekzistuar vepra penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nën par 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së duhet të ekzistoj dëmi i shkaktuar me dashje nga ana e të pandehurit. Dëmi tek kjo vepër është zhvlerësim i aseteve të përgjithshme të ndërmarrjes, apo zvogëlim i pasurisë së të dëmtuarit, ndërsa në rast se ekziston dëmi më doemos duhet të identifikohet i dëmtuari. I dëmtuari nga vepra penale është personi fizik apo juridik të cilit i është shkaktuar dëmi me veprime të kundërligjshme. Pra dëmi është element themelor i figurës së veprës penale në fjalë.

7.1.5. Nga dëshmia e dëshmitarëve A E, A A, A G, R S, B K, M S, Sh P, që të gjithë autotransportues me kamion, është vërtetuar fakti se të njëjtit janë thirrur nga kolegët e tyre autotransportues që të bëjnë transportimin e llamarinë nga fabrika Ndërmarrja e Re “Llamkos”, ku ishin ngarkuar duke i nënshtruar procedurave të matjes dhe pajisjes me dokumentacion përcjellës për transport, ndërsa llamarinën e kishin shkarkuar në fabrikën e re të vajit në Ferizaj “Alcon” pra në depon oborrin e kësaj ndërmarrje.

Dëshmitari Z Z ka deklaruar se llamarinën e kanë dërguar në Prizren por nuk i kujtohej se në cilën firmë të një fabrikë e përpunimit të llamarinës me gypa dhe ulluk. Të gjithë dëshmitarët pa përjashtim kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar për kompaninë “Shen” ndërsa për pagesën për transport kanë deklaruar se janë paguar nga kolegët e tyre, që do të thotë se ashtu si janë deklaruar këta dëshmitarë, paratë i janë dhënë nga ai personi që i ka thirr që të bëjnë transportin, e në secilin rast kishte qenë njëri nga kolegët auto-transportues.

7.1.6. Nga dëshmia e dëshmitarit F J gjykata ka vërtetuar faktin se hapësirat e fabrikës së privatizuar të vajit ushqimorë e cila më vonë ishte quajtur “Alcon” ishin përdorur nga ndërmarrje të tjera si depo. Ndërsa ky dëshmitarë e ka konfirmuar faktin se në oborrin e fabrikës ishte deponuar llamarina.

7.1.7. Nga dëshmia e dëshmitarit N I në lidhje me dëftesën me numër 95/2017 dëshmitari ka deklaruar se ajo dëftesë është lëshuar në arkë që ja ka dhënë menaxheri F R dhe më pastaj ka shkuar në arkë i ka paguar dhe vlera kishte qenë 27,700.00 euro, e cila ishte bërë në emër të “Shen”-it të cilën e kishte paguar dhe ja kishte kthyer dëftesën si shitje.

7.1.8. Nga dëshmia e dëshmitarit D N A është vërtetuar fakti se në kuadër të menaxhmentit të ndërmarrjes në fjalë ka pasur edhe personel bullgar për të cilët ka theksuar se supozon se janë punësuar nga pronari, ndërsa Luani si drejtor kishte pasur një zëvendës i cili ka qenë bullgar me mbiemrin Demenxhija. Po ashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari i cili ka qenë në “Llamkos” drejtor financiar është vërtetuar fakti se kanë pas kontrollë nga AKP si rrjedhojë e kërkimit të rimburesimit të TVSH të cilët e kishin kryer punën e vet duke e caktuar shumën që duhej të rimburesohej, pra “Llamkosi” kishte qenë në parapagim të TVSH me vlera të larta dhe një moment të caktuar kur janë pjekur kushtet ligjore për rimburesimin e TVSH-së e kanë paraqitur kërkesën për kthimin në ATK e që këta të fundit kishin shkuar me vërtetuar saktësinë e asaj çka po kërkohet për kthim duke e lëshuar raportin e tyre lidhur me procesin e kontrollit. Se AKP në ndërhyrje të transaksioneve afariste nuk ka pasur fare lidhje mirëpo e ka rezervuar të drejtën e tyre që kompania ti shitet një pale tjetër pa pëlqimin e AKP.

7.1.9. Nga dëshmia e dëshmitarit G G i cili ka qenë i punësuar pranë kompanisë “Deloitte” e cila në kontratë me AKP ka qenë e angazhuar për mbarëvajtjen e procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në cilësinë e Ndërmarrjes së Re “Llamkos”, është vërtetuar fakti se i dëmtuar nga borxhet e bizneseve “Gini Trade” dhe “Shen” ka qenë Ndërmarrja e Re “Llamkos” sh.p.k, respektivisht pronari i saj pas privatizimit të vitit 2005 Kremikovxi AD nga Bullgaria, Ndërmarrja e Re “Llamkos” sh.p.k ka operuar në treg dhe ka lidhur marrëveshje me këto dy operator si kompani private marrëdhënia e saj me “Gini Trade” dhe “Shen” ka qenë marrëdhënie tregtare mes kompanive private që kanë krijuar të drejta dhe detyrime të caktuara në kuadër të operimit privat në treg. Ndërmarrja e Re “Llamkos” sh.p.k ka operuar si kompani private e pavarura deri me 28 shtator 2009. Ky deklaram i dëshmitarit ka mbështetje edhe në shkresën e tij të datës 26.06.2018 si dhe në shkresën e Drejtorit Menaxhues të AKP e datës 08.06.2018, pra të dy këto shkresa dhe deklarami i dëshmitarit janë në sinkron.

7.1.10. Gjykata përmes provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar se ndërmarrja shoqërore “Llamkos” ishte privatizuar në vitin 2005, në bazë të ligjeve në fuqi, me metodën e spin –off special dhe ishte formuar Ndërmarrja e Re “Llamkos” Sh.p.k e cila kishte operuar si ndërmarrje private dhe e pavarur prej 21 korrik 2005 deri me datën 28 shtator 2009. Ndërmarrja ishte privatizuar nga një kompani Bullgare “Kremikovdzi AD”. Ndërmarrja e Re “Llamkos” Sh.p.k kishte vazhduar me veprimtarinë e njëjtë të prodhimit si dhe kishte punësuar një numër të caktuar punëtorëve ashtu siç e përcaktonin termat e kontratës, ndërsa ishte zotuar

që të investoj edhe një shumë të mjeteve në ndërmarrje me qëllim të rritjes së kapaciteteve të ndërmarrjes. Gjatë kohës sa ndërmarrja kishte qenë në pronësi të kompanisë Bullgare e njëjta kishte hyrë në marrëdhënie biznesi më shumë kompani të tjera, e ndër të tjera edhe më kompaninë “Shen” dhe “Gini Trade”. Nuk është kontestuese se drejtor kishte qenë tani i pandehuri L B, ndërsa në personelin e ndërmarrjes kishte edhe personel Bullgarë, si në pozita menaxhuese ashtu edhe ekspertë të prodhimit. Nga dëshmia e dëshmitarit F R menaxher i shitjes në ndërmarrje është vërtetuar fakti se raportet të shitjes në baza ditore i ishin dorëzuar edhe një ekipit Bullgar që ishte prezent në fabrikë dhe ata si departament i shitjes kishin raportuar në baza ditore dhe komplet shitja kishte shkuar edhe si raportim mujor te pronari dhe përveç raportimeve me shkrim dëshmitari gati çdo muaj kishte shkuar në Bullgari me raportuar për punën e afarizmit të ndërmarrjes. Me pastaj dëshmitari ka shtuar se si departament i shitjes nuk kishte pas asnjë obligim ndaj AKP-së për afarizmin e tyre e as nuk ju ishte kërkuar dhe se nuk kishin qenë në monitorim sepse kishin vepruar si ndërmarrje private, ku shit-blerja kishte qenë kompetence e tyre pa pasur mbikëqyrje nga AKP. Dëshmitari më tej ka deklaruar se ka pasur raste kur ishte shitur mall pa pagesë gjatë kohës sa kishte punuar ai dhe ajo kishte qenë si veresi - borxh gjithmonë me urdhër të pronarit dhe të Kryetarit të Bordit R. Po ashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari është vërtetuar fakti se kishte ndodhur që pagesat nuk ishin kryer në Ndërmarrjen e Re “Llamkos” kur ka pasur marrëveshje me paguar në Bullgari gjë për të cilin i kishin njoftuar dhe nga ana tjetër ishin furnizuar prej pronarit me lëndë të parë.

7.1.11. Në bazë të ekspertizës së ekspertit Xh K të datës 30.11.2022 është vërtetuar kjo gjendje e fakteve; se nga provat e ekspertuara në ekspertizë vërtetojnë që transaksionet e shit – blerjes në mes të “Ndërmarrjes së Re Llamkos Steel” sh.p.k dhe kompanisë “Gini Trade” me seli në Prizren janë realizuar konform dispozitave ligjore në fuqi dhe se të dy kompanitë pritave kanë qenë plotësisht solvente në periudhën e realizimit të shit – blerjes. “Ndërmarrja e Re Llamkos Steel” sh.p.k ka pranuar faturat shitëse nga kompania “Gini Trade” së bashku më dokumentin përcjellës të flet dërgesës dhe ka pranuar mallin, ku me këtë rast është hap flet pranimi i mallit dhe është bërë pranimi kuantitativ dhe kualitativ i mallit dhe i tërë dokumentacioni i kompletuar i blerjeve është dorëzuar në shërbimin financiar. Shërbimi financiar i “Ndërmarrjes së Re Llamkos Steel” sh.p.k duke u bazuar në dokumentacionin financiar valid të pranuar nga magazinimi i mallit, ka bërë pagesat në “cash” nëpërmjet arkës ku në këtë rast janë hap flet pagesat dhe ditari i arkës dhe është bërë pagesa e borxhit. Pra eksperti në ekspertizën në fjalë ka përcaktuar se të dhënat nga dokumentacioni konsideron prova të mjaftueshme për të bërë identifikimi i tatim paguesit si dhe validitetin e tyre në përputhshmëri me dispozitat ligjore në

fuqi e që vërtetojnë validitetin e tatim pagesve, pra këtyre dy kompanive që kanë hyrë në marrëdhënie biznesi. Në bazë të ekspertizës “Ndërmarrja e Re Llamkos Steel” sh.p.k ka shitur ndërmarrjes “Gini Trade” mall në vlerë prej 297,742.89 €, ndërsa nga ato janë inkasuar pra janë paguar nga “Gini Trade” 54,333.18 € ndërsa pjesa tjetër është mbetur borxh dhe nuk ka ndonjë provë që menaxhmenti i kompanisë sa i përket këtij borxhi ka iniciuar procedure për kthimin e mjeteve të papaguara.

Po ashtu ekspertiza e ekspertit Xh K e datës 30.11.2022 në lidhje me kompaninë “Shen” me seli në Prizren, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të fakteve; se e njëjta është regjistruar në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve – ARBK me numër të biznesit 70146613 me pronar A T me numër të lejes ... me seli në Prizren. Ekspertiza ka vërtetuar se “Ndërmarrja e Re Llamkos Steel” sh.p.k (në aktin akuzues dhe në dispozitivet e saj është shënuar si Ndërmarrja e Re “Llamkos”) ka operuar në treg si kompani private e pavarur në periudhën 2005 deri 2009 dhe ka krijuar marrëdhënie tregtare mbi bazën e dispozitave kontraktuale me kompaninë “Shen” duke i shitur mall të gatshëm me pëlqim të Bordit të kompanisë me qëllim të lirimit nga stoqet e grumbulluara të prodhimit të lllamarinës zinkuar. “Ndërmarrja e Re Llamkos Steel” sh.p.k pas kontraktimit të mallit për shitje e ka bërë shitjen e mallit franko depoja e shitësit çka nënkupton që mallin e kontraktuar ja ka dhënë në shfrytëzim blerësit franko – depoja e shitësit, pas shitjes së mallit ka bërë faturimin sipas faturave valide së bashku me dokumentacionin valid financiar, flet dërgesat i janë dorëzuar personit të autorizuar blerësit konform dispozitave ligjore në fuqi.

Eksperti ka konstatuar se këto dy kompani të përmendura më lartë, pra transaksionet e tyre të shit – blerjes janë realizuar konform dispozitave ligjore në fuqi dhe dy kompanitë kanë qenë plotësisht solvente në periudhën e realizimit të shit – blerjes. Shërbimi financiar i kompanisë “Shen” me seli në Prizren duke u bazuar në dokumentacionin financiar valid të pranuar nga magazinimi i mallit të blerësit ka bërë pagesën në shumë prej 27,700.00 € ndërsa pjesa e borxhit tjetër në shumë prej 459,476.93 € ka ngelur e pa inkasuar dhe kjo vërtetohet nga pasqyra financiare e faturave ndaj kompanisë “Shen”. Me qëllim të inkasimit të borxhit kompania “Ndërmarrja e Re Llamkos Steel” sh.p.k me datën 09.10.2007 në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë ka parashtruar padi ndaj kompanisë “Shen” për inkasimin e borxhit.

Në bazë të këtyre provave gjykata po ashtu ka arritur në të njëjtin konstatim sikurse edhe eksperti Xh K i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ekspertiza financiare e punuar nga ekspertja e policisë F T merret me përshkrimin e transaksioneve financiare (hyrje- daljet) e jo me

përshkrimin dhe konstatimin e provave që mbështeten ato transaksione sepse çdo transaksion – pagesë duhet të mbështetet në dokumentacionin mbështetës. Ekspertiza e ekspertit Xh K është një ekspertizë e cila nuk ka paraqitur vetëm në formë tabelare hyrje – daljet e mjeteve monetare por ka përshkruar edhe provat përcjellëse mbi bazën e të cilave janë realizuar transaksionet financiare.

7.1.12. Pra për gjykatën nuk është kontestuese se Ndërmarrjen e Re “Llamkos” në treg kishte operuar si ndërmarrje e pavarur dhe kishte mundësi që të hynte në marrëdhënie kontraktuale me kë do, pra kjo është një e drejtë disponibile dhe po ashtu nuk është kontestuese se AKP nuk kishte as edhe një rol në afarizmin e ndërmarrjes. Është shumë e qartë që blerësi në bazë të kontratës për privatizim me metodën e spin – off special ka bartur rrezikun për afarizmin e tij sikurse në çdo biznes tjetër, por me specifikën se me rastin e privatizimit më metodën e spin – off special pronari rrezikon që ndërmarrjen ta humbasë pra ti merret nga AKP në rast të mos realizimit të zotimeve.

Nga provat e administruara është vërtetuar përtej çdo dyshimi se AKP nuk është e dëmtuar si pasojë e afarizmit të Ndërmarrjes se Re “Llamkos” edhe nuk ka pasur se ti të dëmtohet pasi që nuk ka pasur kompetenca në ndërmarrje. Edhe metoda e spin – off special është shitje e ndërmarrjes por me kushtet të caktuara dhe pasojat e mos afarizmit të mirë të ndërmarrjes i bartë vetë blerësi të cilit mund ti merret ndërmarrja dhe e njëjta të kthehet përsëri nën menaxhimin e AKP-së, gjë që në rastin konkret ka ndodhur. Se AKP nuk është e dëmtuar e ka konstatuar edhe eksperti Xh K në ekspertizën e bërë.

Pra prokuroria e ka trajtuar lëndën e akuzës në atë mënyrë sikur kjo ndërmarrje të ketë qenë nën menaxhimin e AKP-së, e çka është edhe më jo logjike pastaj AKP pretendon se është dëmtuar në vlerën e faturave apo borxheve të ndërmarrjeve “Shen” dhe “Gini Trade” deri sa nuk kishin ndonjë cilësi lidhur me këto transaksione tregtare, pra nuk ishte palë. Kjo Agjenci nuk ka vazhduar procedurën e gjyqësore të iniciuar nga Ndërmarrja e Re “Llamkos” në Gjykatën Ekonomikë në Prishtinë kundër kompanisë “Shen” për ekzekutimin e borxhit kundër kësaj të fundit, padi kjo e parashtruar me datë 09.10.2007, edhe pasi e kishte marrë në menaxhim ndërmarrjen.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në aktakuzën e Prokurorisë Speciale figuron si palë e dëmtuar edhe përkundër shkresës së datës 08.06.2018 të Drejtorit Menaxhues të saj, po ashtu dhënia e

cilësisë së palës së dëmtuar është në kundërshtim edhe më shkresën e datës 26.06.2018 të lëshuar nga Kryesuesi i Ndërmarrjes së Re “Llamkos” në likuidim, G G, i cili ishte angazhuar nga AKP në procesin e likuidimit, e që si proces i paraprinë kthimit të ndërmarrjes në pronësi të AKP për shkak të mos përmbushjes së kontratës.

7.1.13. I dëmtuari si palë në procedurë duhet të identifikohet qartë, pra cilësinë e palës së dëmtuar nuk mund ta gëzoj ndonjë subjekt i cili në kohën e kryerjes së veprës penale si në rastin konkret, nuk ka pasur legjitimitet e as ndonjë kompetencë në lidhje me afarizmin e ndërmarrjes, e as nuk është dëmtuar me vepër penale, ashtu siç është sqaruar në pikë 7.1.4. të këtij aktgjykimi.

Vepra penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën akuzohen të akuzuarit sikurse në dispozitivët e aktakuzës, ka të bëjë më keqpërdorimin e autorizimeve të dhëna nga punëdhënësi, e që në rastin konkret ka qenë ‘Ndërmarrja e Re “Llamkos” dhe jo AKP. I pandehuri L B këto autorizime i kishte marrë nga pronari i ndërmarrjes së privatizuar respektivisht privatizuesi i ndërmarrjes e që ishte kompania Bullgare “Kremikovdzi AD”, ku nga pronari ose kompania Bullgare në fjalë nuk ka as edhe një deklaratë, dëshmi apo diçka që kishte me dëshmuar se i pandehuri L B kishte keqpërdorur autorizimet, apo si në ndonjë mënyrë tjetër ai e ka shkel ligjin apo rregullat e veprimtarisë afariste lidhur me tjetërsimin, përdorimin apo menaxhimin e pasurisë së ‘Ndërmarrja e Re “Llamkos”

Cilat kanë qenë autorizimet e këtij të fundit këtë e përcakton kontrata e tije e punës e lidhur me punëdhënësit, apo këtë do ta dëshmonin edhe dëshmitë e pronarit apo aktoreve të tjerë të përfshirë në menaxhim, ngase siç është cekur edhe më lartë gjykata nuk do ti trajtoj shkeljet eventuale të menaxhimit kororativ, e as nuk do të merret nëse të gjitha departamentet e ndërmarrjes kanë funksionuar bazuar në parimet e këtij menaxhimi, ngase siç është dëshmuar nga dëshmitarët ka pasur edhe devijime nga këto praktika, si pagesa direkt në Bullgari, dhe në lidhje më këto do të duhej të dëgjohej pronari i kompanisë, që në rastin konkret në këtë çështje juridiko – penale nuk ka ndodhur.

7.1.14. Sa i përket të pandehurve D M, Ardian Kelmendi dhe I P të njëjtit akuzohen se kanë kryer Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nën par 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas dispozitivit të akuzës thuhet: *ku pastaj një pjesë e mallit në shumë*

prej 224,820.72 € me urdhrin e të pandehurit L B është transportuar në depon e fabrikës së vajit “Alcon” në Ferizaj, me bashkëpronar të pandehurit D M, Ardian Kelmendi dhe I P”.

Pra të pandehurit D M, A K dhe I P nuk mund ta kryenin në këtë rast veprën penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par. 1 nën par.1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sepse nuk kanë pasur ndonjë autorizim në Ndërmarrjen e Re “Llamkos”, e as kanë qenë persona përgjegjës, pra të njëjtit janë akuzuar se e kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje me të pandehurin L B vetëm se ishin aksionar në Fabrikën e Vajit “Alcon” dhe se llamarina ishte shkarkuar në oborrin e kompanisë së tyre dhe se prokurorisë i ka mjaftuar ky fakt për të ngritur akuzë ndaj tyre si bashkëkryerës. Hapësirat e fabrikës “Alcon” kishin shërbyer për disa biznese për magazinimin e mallit. Pra nuk është vërtetuar në bazë të provave të prezantuara se fabrika “Alkon” kishte ndonjë marrëdhënie biznesi me Ndërmarrjen e Re “Llamkos”.

Më pastaj pjesa e fundit të këtij dispozitivit thekson se; *“ të cilin mall ata asnjëherë nuk e kane paguar dhe ende figuron si borxh ndaj Ndërmarrjes së Re “Llamkos”*. Ky formulim në esencë nuk qëndron pasi që borxhi është një gjendje e bilancit të ndërmarrjes që është ligjor dhe legjitim, dhe arkëtohet në një procedurë tjetër ligjore, (e cila procedure edhe ishte iniciuar) por në rastin konkret nuk është vërtetuar që këtë borxh i kanë shkaktuar këta të pandehur, vetëm për faktin se llamarina e faturuar për ndërmarrjen “Shen” është shkarkuar në oborrin e fabrikës së tyre.

Postulati kryesor i ekonomisë së tregut është qarkullimi i lirë i mallrave. Pronari mallin mund ta shesë, apo ta distribuoj ose liferoj në mënyrën dhe kushtet që i ka kontraktuar, pra disponimi me asete është i lirshëm. Prokuroria në këtë rast nuk e ka identifikuar drejtë palën e dëmtuar, ka dështuar që të marrë ndonjë deklaratë nga pronari, që ai të deklarohet në lidhje me këto transaksione tregtare, se a ka qenë ai në dijeni për të njëjtat, (edhe pse ka prova që shitjet janë bërë me aprovimin e Bordit të ndërmarrjes dhe se raportimet ishin bërë në bazën e kompanisë në Bullgari rregullisht) se a e mbanë përgjegjës të akuzuarin L B apo jo dhe për këtë të paraqesë fakte. Në formën se si është ngritur akti akuzues e gjitha ka mbetur e pa ndriçuar në mungesë të deklaramit të pronarit të atëhershëm të fabrikës dhe e gjithë lënda ka marrë një drejtim të gabuar e cila nuk ka mundur të provohet përtej dyshimit të bazuar mirë. Se pronari i Ndërmarrjes e Re “Llamkos” është aktori kyç në këtë çështje e dëshmon edhe fakti se njëjti i ka bartur konsekuencat kryesore të afarizmit të ndërmarrjes, ku të njëjtit i është marrë ndërmarrja nga AKP për mos përmbushje të zotimit për investime.

Me afarizmin e Ndërmarrjen e Re “Llamkos”, nuk është zhvleftësuar vlera e ndërmarrjes në treg, përkundër nga 4,151.000.00 euro, plus 50,000.00 euro pagesë e depozitit sa e kishte blerë kompania Bullgare “Kremikovdzi AD”, pasi që AKP kishte marrë ndërmarrjen përsëri në menaxhim të njëjtën në një valë tjetër të privatizimit e kishte shitur për vlerën 6,500.000.00 euro plus 900,000.00 euro depoziti, pra çmimi në shitjen e dytë është më i lartë për 2,349.000.00 euro. Një fakt të tillë e ka konstatuar eksperti Xh K në ekspertizën e tij të datës 30.11.2022, ekspertizë kjo e urdhëruar nga gjykata.

7.2. Pastrim i parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par. 1 nën par 1.1, nën par. 1.5 dhe par 3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

7.2.1. Vepra penale Shpëlarja e parave nga neni 302 të KPRK-së e cila përcakton; ”*Kushdo që kryen veprë penale të shpëlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit*”, lidhur me veprën penale të Pastrimit të parave nga neni 56 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e cila përcakton: *kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo që në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke e ditur që pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluara në pajtim me kapitullin IX të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë(dhjetë) vjet dhe me gjobë deri tre (3) herë më të madhe në vlerën e pasurisë e cila është subjekt i veprës penale. Pra veprimet inkriminuese janë si vijon; 1) konverton, transferon apo përpiqet të konvertoj apo transferoj pasurinë me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë. 2) konverton, transferon apo përpiqet të konvertoj apo transferoj pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij, 3) konverton, transferon apo përpiqet të konvertoj apo transferoj pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal, 4) merr, posedon, shfrytëzon apo tenton të merr, posedoj apo shfrytëzoj pasurinë, 5) fshehë ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla, 6) merr pjesë në,*

bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjërit prej verimeve të përmendura.

7.2.2. I pandehuri L B është akuzuar edhe për veprën penale Pastrimi i parave sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimi. Nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se pasuria apo parcela në fjale sipërfaqe prej 10,000 m2, Zona Kadastrale nr.P-... Nerodime e Epërme, Komuna Ferizaj buron nga aktiviteti kriminal. Kjo pasuri është bartur në emër të pandehurit L B në bazë një pune juridike siç është kontrata e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj VR... e datës 20.10.2005. Nuk ka ndonjë ekspertizë financiare në lidhje me këtë transakcion, apo ku qëndron pastrimi i parave ngase në mënyrën e përshkruar në dispozitiv nuk vërtetohet kjo vepër penale.

Pra ky është një transakcion, kundërligjshmërinë e të cilit prokuroria nuk ka arritur ta dëshmoj me asnjë provë. Prova e vetme që është në lidhje me këtë transakcion është kontrata e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj VR... e datës 20.10.2005 e cila në fakt është provë shfajësuese për të pandehurin L B. Fillimisht për të eksituar kjo vepër penale duhet të vërtetohet elementi i dijenisë së të pandehurit se pasuria e cekur, në këtë rast ngastra kadastrale buron nga aktiviteti kriminal. Në rastin konkret në bazë të provave të administruara nuk ka asnjë provë se kjo ngastër kadastrale prejardhjen e ka nga aktiviteti kriminal e rrjedhimisht dhe detyrimisht nuk është provuar as dijenia e të pandehurit. Transferimi i kësaj prone në bazë të një pune juridike të ligjshme, kontrata e së cilës është vërtetuar në gjykatë nuk është bërë me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë në fjalë, ngase dihen palët, dihet marrëveshja edhe nuk ka dyshim se prona është rrjedhojë e aktivitetit kriminal. Ajo që e karakterizon sendet e paluajtshme është qarkullshmëria e tyre, pra të njëjtat mund të kalojnë nga njëri pronar tek tjetri, dhe fakti se ka kaluar apo është transferuar një pasuri nga njëri pronarë tek tjetri, nuk do të thotë se kemi të bëjmë me Pastrim parash, ngase i mungon elementi i kundërligjshmërisë, pra nuk ka prova që prona buron nga aktiviteti kriminal, e as që është bërë me qëllim të maskimit apo fshehjes së burimit. Pra në veprimet të pandehurit nuk është vërtetuar ndonjë përpjekje për të fshehur prejardhjen e paligjshme të pasurisë së fituar me vepër penale.

7.2.3. Në lidhje me veprën penale të Pastrimit të parave me të cilën është akuzuar i pandehuri L B sikurse në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, po ashtu nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale. Në lidhje me transakcionin bankar ku në llogarinë e të pandehurit ishin bartur një shumë e mjeteve prej 100,000.00 euro, në bazë të provave të administruara është

vërtetuar se kemi të bëjmë me një huazim që i pandehuri D Mi kishte dhënë Luanit. Këtë fakt e konfirmon edhe i eksperti Xhevdet Krasniqi i cili deklaron të njëjtën gjë, pra deklaron se transaksione të tilla janë të lejuara dhe se ndodhin në ekonominë e Kosovës. Prokuroria nuk ka arritur që ta vërtetoj përmes provave që paratë paskan qenë si rrjedhojë e krimit dhe që i pandehuri Luan paska qenë në dijeni për këtë.

Narracioni i teorisë së akuzës është bazuar në atë se është marrë si e mirëqenë kryerja e veprave penale Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 290 par.2 lidhur me par.1 nënpar. 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pastaj është bërë zbulimi i të dhënave financiare dhe noteriale dhe çdo transaksion qoftë me pronën apo edhe huazimet si dhe investimet e të pandehurit L B dhe bashkëshortes së tij në biznesin “EML GROUP” - London Taxi (ku në cilësinë e dëshmitarëve kanë dhënë dëshmi edhe bashkëpronarët tjerë) i kanë shikuar nga perspektiva (sikur e dyshimit) që është fare legjitime prej anës së prokurorisë, mirëpo që të njëjtat nuk ishin të mjaftueshme për gjykatën, e cila kërkon një nivel më të lartë të provuarit, pra përtej dyshimit të bazuar mirë, sepse edhe në këtë rast sikurse edhe në rastet tjera gjykata detyrohet që bazuar në nenin 3 të KPPK-së, i cili nen përcakton parimin “in dubio pro reo” mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit interpretohen në favor të pandehurit dhe drejtave të tij.

Lidhur me transaksionin bankar, nuk janë vërtetuar pretendimet e prokurorisë, ngase e njëjta nuk ka arritur që të dëshmoj se si qenkan paratë e D Mt para të cilat kanë rrjedhë nga aktiviteti kriminal, i njëjti këto para i ka bartur në llogari të ligjshme bazuar në ligjet në fuqi për sistemin bankar dhe ky është fakt. Depozitimi si hapi parë në procesin e pastrimit të parave zakonisht bëhet përmes transaksioneve të shumta të vogla ose duke përdorë llogari të ndërmjetësve financiarë, për të fshehur identitetin e vërtetë të pronarit të parave. Në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur, i pandehuri D M këtë huazim e ka bërë me një transaksion të vetëm, me përshkrim si huazim që është konform dispozitave ligjore në fuqi, pra në veprimet e tij nuk ka ndonjë përpjeke për maskimin e origjinës së parave që i ka huazuar të pandehurit L B.

Pra ligjshmëria e transaksionit në lidhje me huan prezumohet, ndërsa kundërligjshmëria faktohet ose provohet. Po ashtu është e pamohueshme e drejta e të pandehurit D M për të poseduar lirshëm me kapitalin e tij dhe të njëjtat ti huazoj, afatizoj, deponoj etj.

7.2.4. Aktakuza e prokurorisë sa i përket pikës IV të akuzës e ngarkon të pandehurin L B se me datën 27.10.2009 ka deponuar në xhirollogarinë e ELM Group sh.p.k shumën prej 1,900.00 euro, me datën 20.12.2009 shumën prej 35,000.00 euro si dhe me datën 21.08.2009 shumën prej 7,500.00 euro. Prokuroria përsëri ka vepruar me logjikën se çdo transaksion është i dyshimtë dhe nga pasqyra financiare e të pandehurit dhe biznesit ELM Group ka nxjerrë hyrje – daljet këtë e ka përshkruar në dispozitiv duke e ngarkuar të pandehurit veprën penale Pastrimi i parave. Gjykata ka arritur te përfundimi se edhe në këtë rast nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se mjetet e deponuara rrjedhin nga aktiviteti kriminal, për më tepër e kundërta është dëshmuar nga dëshmitë e dëshmitarëve Sh S dhe E Z ku ky i fundit ka dëshmuar se kompania në fjalë është themeluar në vitin 2009 nga ai personalisht, M B, L B dhe Sh S. Duke dëshmuar se në lidhje me deponimin prej 35,000.00 euro këto para nuk kanë qenë para të Luan Berishës ngase të njëjtat ishin para të mbledhura nga ky dëshmitar, M dhe vëllai i Sh – B dhe se këto para ja kanë dhënë kompanisë dhe L ka deponuar për kompaninë. Arsyeja e deponimit ishte se ishin porositur veturat nga importi dhe kjo shumë duhej të kompletohej për pagesën e doganës. Sipas këtij dëshmitari fakti se pse i ka deponuar L B ka qenë një arsye praktike për shkak se ai, pra dëshmitari dhe M kanë qenë në Aeroportin e Prishtinës për të bërë pagesën në Doganë për vetura. Pra edhe në këtë pjesë nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar mirë se këto para të deponuara rrjedhin nga aktiviteti kriminal, sepse për këtë nuk ka prova. Ashtu siç kanë deklaruar edhe dy bashkëpronarët e këtij biznesi Sh S dhe E Z ky biznes ka pasur nevojë për mjete shtesë kohë pas kohe, pra bashkëpronarët kanë investuar në forma të ndryshme, duke huazuar dhe ndarë mjete, për t'i mbuluar humbjet, ngase siç është shprehur dëshmitari – bashkëpronari i ELM Group sh.p.k ai si investitorë as edhe investimin nuk e kishte nxjerrë dhe se huat që kishë marrë për investim i kishte kthyer pas shumë viteve. Pra koha e ka dëshmuar se kjo kompani nuk ishte rentabile, ndërsa po të themelohej me qëllim të pastrimit të parave, përmes bilanceve të rreme do të operonte një kohë më të gjatë. Në rastin konkret mund të thuhet se janë përdorur paratë të cilat kanë qenë jashtë rrjedhave bankare (e cila në Kosovë ka qenë një dukuri e shprehur), por nuk është dëshmuar me asnjë provë se ato para rrjedhin prej krimit.

Qarkullshmëria e mallrave të cilat janë në qarkullim juridik është e lejuar me ligj dhe aktet tjera. Nëse një pronë apo transfer ka qarkulluar apo transferuar kjo nuk mund të konsiderohet si tentim për maskim apriori, por është detyrë e organeve të ndjekjes që dyshimin ta argumentojnë me prova konkrete. Prokuroria në lidhje me pastrimin e parave nuk ka prezantuar as edhe një provë të vetme, ne fakt provat që i ka prezantuar janë shfajësuese për te pandehurin L B.

8. Gjykata konform nenit 462 par.1 të KPPRK-së ka vendosur për kërkesën pasurore juridike, andaj të dëmtuarën sipas aktakuzës së prokurorisë Agjencinë Kosovare të Privatizimit AKP për realizmin e kësaj kërkesë e ka udhëzuar në kontest civilo – juridik.
9. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 par.1. të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI SPECIAL

PS.nr.32/19, datë 02.06.2023

Sekretare juridike:

Shqipe Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari:

Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.